



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë më, 18.11.2019, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Prezantimi i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020” (*Komision për dhënie mendimi*)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Halil Jakimi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Robert Bitri, Tatiana Nurçe, Gjetan Gjetani, Ilir Ndraxhi, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermeni, Arben Pëllumbi, Ardit Konomi, Dritan Bici, Arlind Çaçani, Halit Valteri, Nimet Musaj, Kujtim Gjuzi, Klajdi Qama, Zef Shtjefni dhe Edmond Leka.

Mungojnë:

Lefter Koka dhe Andrea Marto.

Të ftuar:

Anila Denaj - Ministre e Financave dhe Ekonomisë

Mimoza Dhëmbi - Drejtoreshë e Përgjithshme e Buxhetit

Endrit Lami - Drejtor i Politikave Makroekonomike

Nikolla Lera - Drejtor i Përgjithshëm i Politikave Makroekonomike dhe Fiskale.

HAPET MBLEDHJA

Niko Peleshi – Përshëndetje!

Fillojmë seancën për projektligjin “Për buxhetin e vitit 2020”.

Për prezantimin e buxhetit, sot kemi në dëgjese ministren e Financave dhe Ekonomisë, zonjën Anila Denaj si dhe drejtoreshën e Përgjithshme të Buxhetit, zonjën Mimoza Dhëmbi, zotin Endrit Lami, drejtor i Politikave Makroekonomike dhe zotin Nikolla Lera, drejtor i Përgjithshëm i Politikave Makroekonomike dhe Fiskale.

Relator i komisionit tonë për këtë projektligj është zoti Ilir Beqaj.

Fjalën ia japim ministres për të prezantuar projektbuxhetin, pastaj vazhdojmë me pyetjet dhe diskutimet e komisionit.

Zonja Ministre, fjala për ju.

Anila Denaj – Faleminderit!

I nderuar kryetar i komisionit,

Të nderuar deputetë,

Ky projektligj, i cili prezanton buxhetin për vitin 2020 vjen pas disa diskutimeve edhe në komisionet e tjera dhe unë shkurtimisht do të përmbledh disa nga pikat kryesore të tij:

Së pari, fokusi i këtij buxheti është konsolidimi fiskal, i cili vijon për të tretin vit radhazi të jetë në trajektoren e parashikuar dhe të rakorduar sikurse ka një projeksion, i cili në gjykimin tonë është në kuadrin realist si në raport me të ardhurat e pritshme të vitit 2019, ashtu edhe ato të vitit 2020, të cilat në vijim do t’i shpjegoj nga se burojnë dhe se cilat janë argumentet kryesore të rritjes ekonomike, e cila ndikon kryesisht në nivelin e të ardhurave:

1. Realizimi i rritjes ekonomike parashikohet të jetë në nivelin 4.1% në vitin 2020, një rritje e gjeneruar kryesisht nga kërkesa e brendshme, si konsumi ashtu edhe investimet. Kjo rritje e parashikuar për vitin 2020 do të përkthehet në:

- krijimin e rreth 35 mijë vendeve të reja pune
- uljen e mëtejshme e shkallës së të papunësisë poshtë nivelit 11%.
- sigurimin e një niveli të lartë të investimeve publike prej mbi 4.5% e produktit të brendshëm bruto, në mbështetje të rritjes ekonomike dhe punësimit.

2. Ruajtja e balancës primare pozitive. Kjo balancë do të jetë pozitive për të pestin vit radhazi në nivelin 0.7% duke synuar mbajtjen e borxhit në trajektoren rënëse. Në fund të vitit 2020 borxhi publik pritet të ulët në nivelin 62.2% të PBB-së, për të zbritur poshtë 60% në 2021 dhe më tej në rreth 57% në vitin 2022.

3. Mbajtja e deficitit buxhetor nën nivelin e 2% është pjesë e objektivit të këtij buxheti. Për vitin 2020 planifikohet të jetë në nivelin 1.6% të produktit të brendshëm bruto, i cili është niveli më i ulët i targetuar në dy dekadat e fundit.

Theksoj se në fund të vitit 2019 parashikohet të jenë në nivelin 1,9%.

Shumë e rëndësishme është të vlerësojmë se si do të jetë pritshmëria e vitit 2019, si rezultat i disa ndryshimeve në të ardhura, të cilat jo vetëm në aktin normativ, por edhe në parashikimet tona të dy muajve të fundit, gjykojmë se do të ketë një realizim në të ardhura më të ulëta sesa ai i parashikuar në fillim të vitit.

Konkretisht, të ardhurat totale të buxhetit në fund të vitit 2019 priten të jenë 474 miliardë lekë, megjithatë, me gjithë uljen në raport me parashikimin, rritja e të ardhurave rezulton 5.4% më shumë se viti 2018 ose 53,4 miliardë lekë më shumë se viti 2018.

Totali i të ardhurave të pritshme në raport me PBB-në në fund të këtij viti rezulton 27.8%, nga 27.6 % që ishte në vitin 2018.

Të ardhurat totale për vitin 2020 parashikohen me një rritje prej 6.2% mbi të ardhurat e pritshme të vitit 2019 ose rreth 29.2 miliardë më shumë.

Shpenzimet buxhetore të programuara për vitin 2020 janë rreth 532 miliardë lekë ose rreth 29.7% e produktit të brendshëm bruto. Ato rriten me rreth 5.1% krahasuar me të pritshmin e vitit 2019.

Prioritet në buxhetin 2020 mbetet mbështetja për sektorët prioritarë, për arsimin, shëndetësinë, bujqësinë dhe infrastrukturën. Këto sektorë janë kyç në ecurinë e një modeli ekonomik që sjell zhvillim të qëndrueshëm dhe rritje që ndikon jetesën e qytetarëve dhe në cilësinë e shërbimeve publike.

Konkretisht disa nga sektorët prioritarë dhe buxhetet në rritje përkatëse të tyre:

- Arsimit i alokohen 3.3 miliardë lekë më shumë se buxheti viti 2019 (buxheti për Ministrinë e Shëndetësisë është rritur me +5%), duke financuar me përparësi:

- Tekste shkollore falas për rreth 230-250 mijë nxënës të arsimit para-universitar nga shtresat sociale në nevojë

- Trajtim me kuotë ushqimore për 1300-1400 nxënës të arsimit para-universitar nga shtresat sociale në nevojë;

- Investim në arsim mesatarisht 750 milionë lekë në vit, përgjatë 2020 – 2022, 2 herë më tepër në nga 340.5 milionë në vit;

- Mbështetje e vazhdueshme për studentët në kuadër të Paktit me Universitetin, i cili edhe këtë vit ka marrë pothuajse 2 miliardë lekë dhe do të vazhdojë të marrë edhe në vitin në vijim.

Sektori i dytë i rëndësishëm për sa i takon jo vetëm fokusit, por edhe rritjes në buxhet të nivelit të të ardhurave për të investuar është shëndetësia, e cila do të ketë 2.75 miliardë lekë me tepër se viti 2019.

Ky buxhet do të mbështesë:

- Rikonstrukcionin e 120 qendrave shëndetësore për vitin 2020, me një vlerë prej 350 milionë lekë.

- Ilaçe të rimbursuar për 1000 pacientë më shumë çdo vit, përgjatë periudhës 2020-2022;

- Efektivitet të shtuar në shërbimet shëndetësore kryesisht në raport me uljen e kohës së pritjes për disa shërbime, siç janë ato të rëndësishme rezonancë, skaner e të tjera.

Sektori i tretë po aq i rëndësishëm dhe i fokusuar edhe në zhvillimin ekonomik është bujqësia, të cilës i akordohen 1.8 miliardë lekë më shumë se viti 2019, ose rreth 12% me tepër.

Sektori i bujqësisë pritet të rrisë produktivitetin dhe konkurrueshmërinë e produkteve bujqësore dhe blegtorale përgjatë periudhës 2020-2022, duke përmirësuar standardet, duke garantuar sigurinë ushqimore dhe zhvillimin e zonave rurale përmes nxitjes së shumëllojshmërisë së veprimtarive ekonomike në zonat rurale.

Për sa u takon shpenzimeve kapitale ose investimeve publike më lejoni të them se përlllogaritet të pësojnë një rritje 4.7% në raport me PBB ose rreth 4% krahasuar me të pritshmin e këtij viti.

Në planifikimin e investimeve për vitin 2020 janë mbajtur në konsideratë të gjitha detyrimet kontraktuale për projektet e investimeve me financim të huaj dhe të brendshëm.

Ashtu, si edhe në vitin 2019, dhe në vitin 2020 do të ketë përparësi financimi i projekteve në vazhdim, duke synuar mbylljen e tyre brenda vitit 2021, sikurse do të ketë përparësi edhe

shlyerja e detyrimeve të prapambetura përkatësisht në rastin e infrastrukturës rrugore për rrugët, të cilat janë përfunduar dhe detyrimet kontraktuale janë ende duke u audituar nga autoriteti kontraktual.

Sa i takon infrastrukturës rrugore për periudhën 2020-2022 synohet kompletimi i akseve rrugore nacionale dhe segmenteve në vazhdim, konkretisht të shumë rrugëve, të cilat sot për arsye të nevojës për financime, kanë nevojë për të shtyrë disa nga investimet e tyre me të paktën një vit.

Për sa i takon balancës korrente fiskale për këtë vit programohet gjithashtu ndër nivelet më të larta të dy dekadave të fundit prej +3.1% të PBB, ndryshe për 100 lekë të marra borxh programohen 286 lekë investime publike, raport i përmirësuar ndjeshëm krahasuar me mesataren e këtij treguesi për periudhën 2014-2019, ku për çdo 100 lekë të marra borxh janë shpenzuar për investime publike 193.

Në fushën e sigurisë kombëtare, kemi rritur buxhetin e mbrojtjes me rreth 2.8 miliardë lekë më shumë krahasuar me buxhetin e vitit 2019, për të garantuar realizimin e objektivit të qeverisë dhe angazhimet tona në NATO duke synuar që për vitin 2024 të arrijmë 2% të PBB.

Ky buxhet gjithashtu plotëson të gjitha nevojat financiare të të gjitha institucioneve të reja, të krijuara nga paketa e Reformës në Drejtësi. Më lejoni të them se që këtë vit ne kemi përmbushur të gjitha detyrimet financiare për të gjitha institucionet, të cilat financojnë reformën në drejtësi me një buxhet prej 2.6 miliardë lekë.

Për vitin që vjen ky buxhet i shtuar shkon +1.1 miliardë lekë po të mos përmendim edhe 300 milionë lekë të fondit rezervë që i takojnë reformës në drejtësi.

Më tej buxheti alokon një fond të rëndësishëm për skemën e sigurimeve shoqërore : për vitin 2020 parashikohet në masën 137.5 miliardë lekë ose 7.7% e PBB-së.

Në skemën e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2020 janë parashikuar në rreth 44 miliardë lekë ose 2.5% e PBB-së, 2 miliardë lekë më shumë se viti 2019.

Fondi për kompensimin në vlerë të pronarëve parashikohen në total rreth 4,5 miliardë lekë nga rreth 1.9 miliardë lekë që ky fond ishte në vitin 2013.

Shpenzime të tjera sociale janë programuar në masën 24.6 miliardë lekë, që përfshijnë:

- Shpenzimet për pagesën e papunësisë në nivelin 600 milionë lekë.
- Shpenzimet për pagesën e ndihmës ekonomike dhe personave me aftësi të kufizuar në nivelin 21 miliardë lekë

- Për ish-të përndjekurit është parashikuar një fond prej 1 miliard
- Për bonusin e lindjeve sërish është parashikuar një fond prej 2 miliardë lekë

Edhe në këtë vit, nga kjo politikë pritet të përfitojnë rreth 30 mijë familje gjatë 2020.

Niveli i fondit rezervë për vitin 2020, planifikohet në masën 1.7 miliardë lekë, përkatësisht 1.4 miliardë lekë fond rezervë i Këshillit të Ministrave dhe 300 milionë lekë fond kontigjence për financimin e reformës në sistemin e drejtësisë.

Buxheti i pushtetit vendor për vitin 2020 është programuar në rreth 57 miliard lekë, rreth 11.2 % më i lartë se ai i 2019-ës ose rreth 5.7 miliardë lekë më shumë fonde për shërbime dhe investime publike vendore.

Kjo rritje prej 3.2% në raport me PBB-në i shërben:

- Konsolidimit të procesit të menaxhimit të financiar vendore,
- Zbatimit të reformës administrativo territorial,
- Decentralizimit fiskal të njësive të vetëqeverisjes vendore
- Uljes së stokut të detyrimeve të cilat përlllogariten në nivelin 6.7 miliardë lekë, por

më lejoni të them që janë në zbritje nga 11.6 miliardë lekë që ishin në vitin 2016, kur filloi edhe reforma administrative territoriale.

Ashtu si në buxhetin e vitit 2019, edhe ky projektbuxhet shoqërohet nga disa risqe për të cilat Ministria e Financave dhe Ekonomisë është angazhuar t'i shmangë ose eliminojë.

Së pari, në raport me realizimin e të ardhurave, si edhe këtë vit ne jemi përballur me disa problematika, të cilat në vijim të pyetjeve dhe diskutimeve tuaja jemi të gatshëm t'u përgjigjemi se cilat kanë qenë arsyet e mosrealizimit të projektplanit të të ardhurave në vitin 2019. Më lejoni të theksoj se për vitin ardhshëm duke filluar nga fakti që baza është më e ulët, por njëkohësisht duke përgatitur edhe disa procese të cilat do të fokusohen në miradministrimin e administratës tatimore dhe doganore, jemi të bindur se këto të ardhura do të jenë në përputhje me projeksionin.

Ky risk, i cili u evidentua këtë vit dhe sikurse do ta them edhe më vonë, ka të bëjë me disa faktorë dhe jo vetëm me miradministrimin, mendojmë se vitin tjetër do të kompensohet në mënyrë të ndjeshme.

Risku i dytë është ekspozimi i buxhetit ndaj pagesave të PPP-ve. Faktikisht këtë vit si Ministri Financash kemi marrë një rol të shtuar në raport me menaxhimin e PPP-ve, pasi me ndryshimin e ligjit roli i ministrisë sonë shkon si një rol i shtuar i monitorimit të të gjitha kontratave. Jemi në një proces të mbledhjes së informacionit nga të gjitha autoritetet

kontraktuale. Nuk e kemi përfunduar atë plotësisht, por besoj se brenda këtij viti do të përfundojë, sikurse kemi mbështetje edhe nga ekipi i FMN-së, i cili po na asiston për të ngritur kapacitetet dhe për të na trajnuar se si të lexojmë më mirë risqet fiskale të kontratave ekzistuese apo atyre të ardhshme.

Me miratimin e ndryshimeve të këtij viti në ligjin për koncesionet dhe partneritetit kemi shumë për të mësuar por është shumë e rëndësishme të vlerësojmë sesi ndikojnë këto risqe fiskale. Më lejoni të them që përqindja mbi tavanin buxhetor është në nivelin 3 % nga 5 % të ligjit për buxhetin.

Për sa u përket risqeve të tjera shpesh diskutojmë mes nesh për riskun e huamarrjes, viti tjetër do të jetë një vit i rëndësishëm për të dalë në tregje ndërkombëtare për eurobondet. Ministria e Financave ka një eksperiencë shumë të mirë të daljes në tregje ndërkombëtare të kapitalizuar tashmë edhe në eksperiencë të stafit të saj për mënyrën se si menaxhohet ky proces. Kemi parashikuar të dalim pak më herët vitin e ardhshëm në tregjet internacionale. Maturiteti i eurobondit në nëntor nuk do të na pengonte të dalim në tregjet ndërkombëtare në maj, qershor pasi parashikohet që të jetë një periudhë shumë e mirë për të realizuar jo vetëm përfitueshmërinë në raport me procesin, por edhe në raport me normën e interesit.

Megjithatë, në fondin tonë të kontgjencës ne i kemi marrë masat që edhe nëse do të kishte rritje të normës së interesit, gjë që nuk e parashikojmë, duhet të kemi mjaftueshëm rezervë për risqe të ndryshme, të cilat nuk i menaxhojmë dot sot. Në tregjet rojonale kemi vënë re që edhe Serbia dhe Mali i Zi kanë realizuar me sukses muajt e fundit me illde pozitive, por njëkohësisht më të ulëta se sa vitet e mëparshme.

Në raport me risqet, trajtimi dhe frenimi i detyrimeve të prapambetura. Sa i takon detyrime të prapambetura, ministria e Financave ka në objektivin e saj parësor uljen e detyrimeve. Sigurisht, detyrimet nuk mund të ulen brenda një dite apo një vit, e rëndësishme është që të gjitha institucionet si ato të pushtetit vendor, ashtu edhe ato të pushtetit qendror të ndërgjegjësohen për faktin që këto detyrime janë të parat para se të nis dhe projekttohet çdo projekt tjetër.

Në këtë proces dy janë qasjet jo vetëm në raport me komunikimin e drejtpërdrejt me ta dhe uljen e tyre, por njëkohësisht edhe në çeljen e fondeve ku vihet në plan të parë pagesa e detyrimeve të prapambetura.

Së fundi, në raport me detyrimet e prapambetura që kanë të bëjnë me taksapaguesit dhe kryesisht atë që ka të bëjë me detyrimin e TVSH-së së rimbursueshme ne kemi marrë nisma, të cilat sot mund t'i konkretizojmë në dy grupe: së pari, atë juridike, të cilën do ta shikoni edhe në trajtimin e paketës fiskale, që në fakt nuk është një paketë e mirëfilltë, por është një ndryshim masash ligjore për të ndihmuar miradministrimin në fokus për vitin tjetër, ku detyrimi i palëve për të vendosur marrëdhënie me pagesë me këste bëhet juridikisht korrekt dhe kjo për të mundësuar që dy apo tre tatimpagues, të cilët kanë një nivel më të lartë stoku të TVSH-së të kenë mundësinë të paguhet me këste, sikurse të gjithë taksapaguesit e tjerë të paguhet në kohë reale. Këtë vit kemi shlyer me një ritëm më të madh sesa viti i kaluar me gati 40% më shumë detyrimet e prapambetura të lidhura me TVSH-në dhe parashikohet që vitin tjetër me një fond prej 21 miliardë lekësh shlyerja e detyrimeve të prapambetura do të shkojë në nivelin e 60 % më shumë sesa i vitit 2018, sigurisht, për të shkuar në nivelin zero, detyrime të prapambetura me TVSH-në qershor të vitit 2021.

Faleminderit për vëmendjen!

Niko Peleshi – Faleminderit, zonja Ministre!

Ju lutem, ka pyetje rreth projektbuxhetit?

Po, zoti Baraj.

Besnik Baraj – Faleminderit!

Komplimente për formën shumë të përmbledhur duke ndalur në elementet më të rëndësishëm të buxhetit. Njëkohësisht këto elemente janë sensitive edhe në median sot.

Kisha këto pyetje: sa parashikohet të jetë rritja ekonomike për vitin që vjen? E para.

E dyta, në vlerësimin tuaj sa është informaliteti në ekonominë shqiptare sot, meqenëse ku është një element shumë i rëndësishëm për buxhetin? A keni plane për ta zvogëluar këtë informalitet?

Niko Peleshi – A ka pyetje të tjera?

Po, zoti Shtjefni.

Zef Shtjefni – Zonja Ministre,

Ju folët për buxhetin e arsimit dhe se ky buxhet ka rritje. Dua të di, edhe pse ky buxhet për arsimin ka rritje, pse studentët në fillim të muajit duan të bëjnë një protestë? A është e bollshme kjo rritje e buxhetit? Ju thatë se për të gjitha ministrinë kishte rritje në buxhet. Po Ministria e Brendshme a ka rritje në buxhet? Dua të di nëse ka rritje buxheti i Ministrisë së

Brendshme, pasi punonjësit e kësaj ministrie sigurojnë rendin dhe qetësinë publike në Republikën e Shqipërisë. Po buxheti vendor? Kjo është pjesa që më intereson më shumë. Para 10 minutash ky buxhet na u vu përpara, prandaj dua të di se si do të jetë shpërndarja në bashkitë e Shqipërisë, kryesisht bashkia në Shkodër, për të cilën jam i interesuar më shumë, si dhe pjesa e Veriut të Shqipërisë. A do të ketë ndonjë rritje këtë vit?

Faleminderit!

Niko Peleshi – Zoti Valteri, fjala për ju.

Halit Valteri – Po e shihja përciptazi buxhetin, nuk është se e kam parë me shumë vëmendje, por në asnjë moment nuk shoh se çfarë është parashikuar për shtresën e komunitetit rom, si dhe shtresat në nevojë. Dua të di sa para janë parashikuar për këto shtresa dhe për integrimin e tyre në shoqëri, për strehimin, shkollimin? Ju thoni se keni 3 miliardë lekë për Paktin për Universitetin dhe te ky pakt a është përfshirë kjo kategori njerëzish? Çfarë është bërë për këtë kategori?

Zonja Ministre, me aq sa unë kam dijeni, ju është bërë një kërkesë nga dy organizata të këtij komuniteti, ku edhe unë jam munduar të lidhem me stafin tuaj, për t'i pritur dhe për t'u treguar se për çfarë kanë nevojë këta njerëz. Por këtu te ne ndodh e çuditshmja, vetëm njerëzit nuk dëgjojnë, gjithkush, lloj-lloj hajvani dëgjojnë në atë sallë duke thënë budallallëqe, kurse njerëzit që kanë nevojë nuk dëgjojnë. A mund të jepni një përgjigje se çfarë është bërë me këtë lloj shtrese?

Faleminderit!

Niko Peleshi – Zonja Gjermani, fjala për ju.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, kryetar!

Zonja Ministre, ju falënderoj për prezantimin e detajuar!

Kam dy pyetje që lidhen me ministrinë që ju drejtoni, sa i takon strehimit në përgjithësi. Sa është fondi për këtë vit dhe çfarë programesh do të mbuloni? Doja të dija diçka më shumë edhe sa i takon mbështetjes ndaj sipërmarrjes dhe objektivat që keni për të mbështetur sipërmarrjen e mesme, të vogël, biznesin e kështu me radhë. Çfarë mendoni në këtë drejtim?

Faleminderit!

Niko Peleshi – A ka pyetje të tjera?

Zoti Bitri dhe zoti Pëllumbi e ka fjalën më pas.

Robert Bitri – Zonja Ministre kam këto pyetje. Sa për qind e TVSH-së është shlyer në Republikën e Shqipërisë, sidomos sa i takon prodhimit bujqësor, sidomos pjesës së grumbulluesve? Si është e vërteta e sigurimeve shoqërore ose e thënë sipas jush, mos ndodhet te pjesa e fondeve të prapambetura që nuk janë mbledhur? Sa vjet ka që vazhdon kjo dukuri, është që nga viti 2013 e këtej apo edhe më parë? A mos është më mirë që ju të dilni në televizion sapo del problemi dhe ta sqaroni drejtpërdrejt, sepse duke e lënë në këtë mënyrë propaganda ka efekt shumë negativ? Duhet thënë që kjo ka qenë pjesë, Moza dhe zotëria janë të vjetër, kanë kaluar qeveri të majta dhe të djathta, i dinë mirë këto punë, prandaj duhet të na heqin mendimin që kjo është metodikë pune apo është diçka që duhet eliminuar sa më shpejt.

Si e keni menduar zgjidhjen e problemit të borxheve të prapambetura të pushtetit lokal? Në të vërtetë kjo çështje mund të zgjidhet dhe kjo do të jetë prioritet për pushtetin lokal që t'i shlyejnë, mirë është t'i shlyejë, por ka pushtete lokale që këto borxhe i kanë shumë të mëdha dhe i bie pastaj të mos funksionojnë fare pushteti lokal.

Niko Peleshi – Zoti Pëllumbi, fjala për ju.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, zonja Ministre, për gjithë parashtrimin që na bëtë, si dhe dua t'ju përgëzoj për këtë bilanc të buxhetit që na paraqitët!

I dëgjova dhe i mbajta shënim të gjitha ato që thatë. Vërtet rritja ekonomike është 4,1% dhe ndoshta mund të jetë e pamjaftueshme për t'u ndier në xhepat e të gjithë qytetarëve shqiptarë, por gjithsesi është një rritje ambicioze. Gjithashtu, mbajta shënim që pretendoni të kemi rreth 35 mijë vende të reja pune, edhe kjo është diçka që duhet përgëzuar. Kemi investime më të larta prej rreth 4,5%, si dhe vazhdojmë të kemi një bilanc primar pozitiv dhe ajo që është më e rëndësishme është fakti që po tentohet të ulet borxhi publik dhe për vitin që vjen keni menduar të jetë 62,2%. Mendoj se janë të sakta këto që kam mbajtur shënim.

Nëse do të arrini t'i realizoni këto lloj treguesish keni përgëzimet e mia.

Dua t'ju bëj një pyetje, sepse besoj se ne si komision nuk do t'i hyjmë me themel paketës fiskale. Sa i takon incetivimit në sektorin e industrisë automobiloje, pse e kemi në këtë paketë? Cili është qëllimi që bëhet kjo gjë?

Faleminderit!

Niko Peleshi – A ka pyetje të tjera?

Kam unë 2-3 pyetje të shkurtra, pasi një pjesë të tyre u ezaurua nga kolegët...

(Diskutime pa mikrofon)

Cili është sektori apo prioriteti që ka rritje më të madhe në këtë buxhet sa i takon vitit që vjen? A mund të më jepni një informacion lidhur me performancën e të ardhurave personale të TAP-it, që nga zbatimi i taksës progresive e deri më sot, si po ecën ky tregues dhe si parashikohet? Si është situata me rimbursimin e TVSH-së, a kemi borxh të akumuluar dhe sa është ky borxh?

Kam edhe një pyetje tjetër, ndoshta kjo i takon Ministrisë së Transportit, por meqë ka lidhje me buxhetin edhe ju duhet të keni informacion. A do të ketë financim për vazhdimin e rrugës Qukës-Qafë Plloçë për vitin 2020? Ndërkohë, mbi 50, në mos 60 apo 70% e rrugës ka mbaruar, por për mungesë financimi kantieri ka mbetur i hapur, i cili natyrisht amortizohet çdo ditë duke u kthyer në një kosto të madhe, sidomos kur bëhet fjalë për zonat malore ku lartësia arrin mbi 1000 metra mbi nivelin e detit, pra janë zona që kanë disa muaj dëborë, kështu që amortizimi në kantier është shumë i lartë.

Faleminderit!

Vijojmë me përgjigjet.

Zonja Denaj, fjala për ju.

Anila Denaj – Faleminderit!

Përgjigjet po jua jap në mënyrë kronologjike, por deri diku 2 deri në 3 pyetje konvergojnë kështu që do i përmbledh në të njëjtën, duke i bërë referencë edhe zotit deputet që e ka bërë.

Po e nis nga rritja ekonomike. Siç jua thashë në fjalën time, rritja ekonomike parashikohet në nivelin 4,1% për vitin që vjen. Sigurisht, për të qenë të qartë se si arrin 4,1-in më lejoni t'ju them konkretisht se konsumi total parashikohet të rritet në terma realë me rreth 2,5%, duke dhënë një kontribut në 4,1% me 2,3 pikë/përqindje; investimet totale, të cilat rriten me 4,3% ose me një kontribut rreth 1 pikë/përqindje; kërkesa e huaj neto, e cila përmirësohet me 5% kontribuon me 0,8 pikë/përqindje. Pra, duke mbledhur 2,3, 1 dhe 0,8 na e jep 4,1% rritjen ekonomike.

Parashikimi sa i takon rritjes ekonomike për vitin 2019 pati një ndikim të konsiderueshëm në 6-mujorin e parë të këtij viti, efekti i energjisë, duke ndikuar me 1 pikë/përqindje dhe duke ulur ritmin e rritjes të parashikuar mbi 4% në nivele poshtë 3%-it. Kjo sjell ndikim të drejtpërdrejtë edhe në të ardhurat, pasi ne kemi përllogaritur që vetëm nga ndikimi i rritjes ekonomike të rishikuara për vitin 2019 të ardhurat në fund të vit në raport me

parashikimin do të ndikohen në masën 2,8 deri në 3 miliardë lekë. Megjithatë synojmë, duke u nisur nga një bazë e ulët dhe duke parashikuar këtë element, që jua thashë pak më parë, që premiset për vitin që vjen të jenë më optimiste, por më shumë se optimiste janë realiste, pasi të gjitha elementet që ju thashë si konsumi ashtu edhe investimet mund të kontribuojnë në mënyrë të ndjeshme të 4,1%-i, duke menduar që edhe baza vjen më e ulët.

Në terma dhe vlera absolute besoj që kur të flasim për të ardhurat nën për nën do t'i shohim konkretisht.

Sa i takon informalitetit, më lejoni, zoti Baraj, të mos përmend një shifër, e cila nuk është zyrtare, pasi do të ishte jo korrekte nga ana ime si ministër e Financave dhe Ekonomisë të përmend një shifër të informalitetit kur nuk ka një bazë për ta matur atë. Edhe në daljet e mia publike kam bërë referencë evidencën që kemi pasur këtë vit në përpjekjen tonë për të rritur miradministrimin dhe ku kemi intensifikuar vizitat në subjekte, jo vetëm në ato me subjekt të administratës tatimore, doganore, por edhe të inspektoratit të punës ku në raport me numrin, jo me vëllimin, pothuajse 40% e inspektimeve kanë rezultuar me shkelje. Sigurisht, këto shkelje nuk vlerësojnë nivelin në vlerë monetare, por megjithatë gjykojmë që numri i inspektimeve në raport me 2 vjetët e shkuara ka qenë më i lartë dhe gjetje të tilla me shkelje në nivelin e 40%-it na vënë përpara përgjegjësisë dhe të gjykojmë që informaliteti është i lartë.

Megjithatë, informaliteti nuk paraqitet vetëm në aspektin e kuponit apo të Inspektoratit të Punës, por ne e vërejmë sot një element të shtuar të pasqyrave financiare jo të shëndetshme në raport me realitetin, pasi jemi duke vlerësuar se si të incitohet që pasqyrat financiare të biznesit të jenë sa më afër realitetit dhe çdo zë i pasqyrave financiare, si bilance apo pasqyrë përfitueshmërie dhe shpenzimesh për biznesin të jenë më afër asaj që ai qarkullon. Jemi të bindur që për këtë do të duhet më shumë sesa një ligj fiskalizimi, por ka një fillim.

Ligji i fiskalizimit, i cili do të diskutohet edhe në këtë komision si pjesë e paketës fiskale nuk synon reduktimin e informalitetit vetëm si ligj, sigurisht përmirëson të dhënat. Administrimi i të dhënave nëpërmjet administratës tatimore është mjaft i rëndësishëm. Unë vlerësoj që administrimi i të dhënave sot bëhet, por nuk bëhet në atë nivel të shtuar që do të donim të ndodhte dhe administrata tatimore është në një proces rishikimi strukturash qoftë të brendshme edhe të atyre të inspektimit. Në fokusin tonë për vitin që vjen është fakti se si administrata tatimore duhet ta ndryshojë jo vetëm skemën dhe strukturën e saj, por edhe qasjen ndaj biznesit.

Elementet e matricave të riskut janë implementuar sot si element i shtuar dhe me një qasje për të evidentuar vizita fiskale ndaj biznesit me risk të lartë dhe jo duke shkuar rëndom. Siç jua thashë edhe më parë, ky është një proces që do të kërkojë një vit e gjysmë deri sa të standardizohet, por një gjë është e sigurt që në këtë proces nuk jemi vetëm. Edhe në raport me strukturat dhe me proceset e brendshme kemi mbështetjen e strukturave ndërkombëtare, respektivisht të FMN-së dhe të Bankës Botërore në veçanti.

A është e mjaftueshme shuma që i është dhënë arsimit? Asnjëherë nuk është e mjaftueshme as shuma që kemi dhënë në arsim, as shuma që japim në shëndetësi. Po ta vlerësojmë në përqindje ndaj produktit të brendshëm bruto, sigurisht shëndetësia duhet të ishte në nivele sa më të larta sesa 3% e produktit të brendshëm bruto, që është megjithatë rritja nga një vit në tjetrin vlen për t'u përmendur. Kjo rritje është rreth 2,75 miliardë lekë në shëndetësi, 3,3 miliardë lekë në arsim. Vlen për t'u gjykuar se përse studentët do të dalin përsëri, por n mendoj që kjo nuk është një pyetje për mua si ministre e Financave. Vlerësoj se e gjithë përpjekja për të akomoduar arsimin parashkollor, universitar apo atë profesional janë fakte për të cilat vitet e fundit shifrat flasin vetë. Besoj se komunikimi më i intensifikuar me studentët duhet të jetë absolutisht në fokus, por shifrat janë aty kokëforte për të treguar se mbështetja nuk ka munguar asnjëherë.

Sa i përket Ministrisë së Brendshme, siç jua thashë pak më parë edhe në relacionin që ju paraqita, kemi nevojë ta përmirësojmë cilësinë e shërbimit. Besoj se të gjithë jeni të ndërgjegjshëm, edhe me aktin normativ, se një pjesë e konsiderueshme e parave rreth 450 milionë lekë shkuan për pagesat e orëve shtesë. Më lejoni t'ju theksoj se pagesa e orëve shtesë nuk mund të jetë një qëllim në vetvete, por rritja e numrit të policisë për banorë është një objektiv i Ministrisë së Brendshme në mënyrë që të sigurohet një qasje më cilësore drejt standardeve rajonale dhe ndërkombëtare dhe besoj se edhe në këtë projektbuxhet rritja e këtij numri është e dukshme.

Pushteti vendor.

Sigurisht pushteti vendor pas reformës së ndodhur në vitin 2016, ka marrë jo vetëm një fokus të rëndësishëm në nivelin e të ardhurave, por ka marrë edhe një vetadministrim më të madh. Bashkitë, duke filluar nga këshillat bashkiakë, edhe kryetarët e bashkive, duhet ta kuptojnë që roli i tyre dhe oportuniteti që ata kanë për të rritur jo vetëm të ardhurat, por edhe të për të ekonomizuar shpenzimet, qoftë për të ndihmuar për të ndihmuar në infrastrukturë, në

komunitetin rom apo strehim, janë pjesë e një politike dhe decentralizimi që vjen me reformën. Rritja e nivelit të të ardhurave në pushtetin vendor si këtë vit dhe vitin që vjen, siç e thashë edhe në prezantim është gati 2,3% e produktit të brendshëm bruto me një ritëm të shtuar nga vitet e shkuara, është një tregues pozitiv dhe nga një vit në tjetrin këta tregues janë duke u rritur.

Pushteti vendor ka ende hapësirë për të shfrytëzuar taksën e pronës. Pas Regjistrimit të Kadastrës Fiskale, i cili është një projekt i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë konstatojmë që ende ka këshilla bashkiakë që nuk kanë marrë vendimet e tyre brenda hapësirës juridike. 33 bashki ende nuk kanë marrë vendime në raport me taksën e pronës. Më pas kjo duhet komunikuar dhe duhet vendosur edhe në perspektivë të kadastrës fiskale për të krijuar një perspektivë më të mirë të të ardhurave dhe për të mos ngelur vetëm pjesë e grantit të pakushtëzuar të qeverisë, e cila shpërndahet në mënyrë të barabartë, sipas një formule të përcaktuar dhe që është e vendosur në ligj. Megjithatë, për këtë formulë besoj se informacionin mund t'ju japim dhe ta shohim në kontekstin e vlerave monetare për secilën bashki. Formula nuk përcaktohet nga kryetarët e bashkive që janë, sepse mund të jenë të kujtdo force politike, është një formulë e vendosur në ligj dhe ne bëjmë respektivisht vetëm zbatimin e saj.

Këtë mund t'ju jap me fakte dhe besoj se nuk është çështje diskutimi, por është çështje shifrash dhe nëse aty ka një gabim jemi të hapur ta korrigjojmë, por formula është e mbështetur në aktet juridike.

Për sa i takon mbështetjes ndaj sipërmarrjes, ne jemi aktualisht të angazhuar në disa procese në përmirësimin e klimës së biznesit, si në procesin e shërbimit ndaj tatimpaguesve, në radhë të parë, me shërbime online dhe shërbimet e integruara, të cilat vijnë nga disa institucione, dhe jo vetëm nga institucionet në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në mënyrë që si biznesi, ashtu dhe qytetari të marrin shërbime në kohë dhe me sa më pak burokraci, apo me kontaktin fizik me punonjësit për të shmangur elemente të caktuara abuzive dhe korruptive.

Komuniteti European është duke i dhënë Shqipërisë një mbështetje si pjesë e procesit të integritetit european brenda një reforme, e cila parashikon 18 reforma dhe prej marsit të këtij viti ne jemi të koordinuar me disa ministri të linjës dhe nëse ka interes, unë mund t'ju vë në dispozicion ditët në vijim.

Megjithatë mbështetja më e madhe ndaj sipërmarrësve, përveç shërbimeve publike korrekte në kohë dhe me kosto optimale, është pagesa e detyrimeve, sidomos ato të TVSH-së që, për disa nga zotërinjtë deputetë u ngrit sot si një çështje.

Na rezulton se në muajin nëntor ne kemi paguar një shumë të konsiderueshme me 40% më shumë se viti i kaluar në raport me detyrimet e prapambetura, të gjithë pjesën e eksportuesve, grumbulluesve dhe fasonëve e kemi të likuiduara, tabelën nuk e kam këtu, por mund ta sjellë zoti Lera, sepse shifrat i kemi, nuk është ky problemi. Ne kemi një strukturë të tillë detyrimesh të prapambetura në raport me TVSH-në, që besoj duhet të dihet, ku 2/3-t e stokut të TVSH-së janë nga 2-3 tatimpagues të mëdhenj, të cilët me ndryshimet e ligjit në paketën fiskale do të kalojnë me këste dhe do të krijojnë një lehtësi, që brenda afatit të parashikuar, të jenë 100% të paguara në kohë.

Ndërkohë që unë u përgjigjem pyetjeve, zoti Lera merr përgjigjen e stokut.

Si është e vërteta e ISSH-së?

Detyrimet e prapambetura të ISSH-së sot që flasim dhe të përlllogaritura në vleftën e 12,5 miliardë lekë, konkretisht 10,4 miliardë lekë principal, 1,2 gjoba dhe 800 milionë lekë interesa janë në një total prej 75 mijë e 612 subjekte, nga të cilat pjesën më të madhe e bëjnë subjektet jobuxhetorë, subjektet juridike dhe biznesi i vogël, që kanë një qasje të tillë të detyrimeve prej vitit 2000, sigurisht në vlera më të vogla. Ne kemi nisur një analizë të detajuar jo vetëm të arsyeve, por edhe për faktin që këto detyrime në fund duhet të vënë para përgjegjësisë subjektet, pavarësisht nga statusi i tyre i kompanive (pjesa më e madhe e tyre janë në status inaktiv) dhe administratën përgjegjëse për mbartjen e këtyre detyrimeve në kohë. Kjo është një nga arsyet pse unë ende nuk kam dalë, por ka dalë drejtori i ISSH-së, ka dalë Ministria e Financave. Unë si ministre do të dal në momentin e adresimit të marrjes së masave të mbartura prej vitit 2000, duke përfunduar të gjithë procesin e auditimit, që kam nisur.

Spektori me rritjen më të lartë është ai i arsimit në kontekst me vlerën absolute, kurse shëndetësia, mbrojtja dhe bujqësia, e respektivisht në shifrat që unë përmenda në fillim të fjalës sime, janë sektore prioritarë. Politikë fiskale të mirëfilltë, që do të prezantohet si një paketë nën për nën përtej diskutimit në parim, nuk ka këtë vit. Ne jemi në një proces analize të një strategjie të të ardhurave në nivel afatmesëm, e cila synon në dy aspekte:

E para, në një analizë të të gjithë sistemit fiskal në raport me tatimin mbi fitimin, me atë progresiv të këtyre viteve dhe lehtësitë fiskale që mund të jenë bërë ndër vite për të analizuar se cilat janë përfitimet lehtësimeve dhe se si skema sot mund të jetë më koherente për 4 vitet në vijim. Në këtë proces kemi edhe mbështetjen e FMN-së dhe besoj se vitin tjetër, duke kërkuar mbështetjen e grupeve të caktuara të interesit, por edhe të deputetëve, do të ishim të kënaqur të

diskutoni një paketë të mirëfilltë fiskale për 3-4 vitet e ardhshme. Në fokus të këtij viti caktoam tri elemente: miradministrimin nëpërmjet ligjit të fiskalizimit dhe 2-3 elemente të vogla administrativo-juridike, të cilët ndihmojnë si në kontekstin e pagesës së detyrimeve të prapambetura, ashtu dhe në intensifikimin e përpjekjeve për të luftuar informalitetin me masa administrative më korrekte dhe më proporcionale.

Së dyti, automativët, të cilët janë në qasje të paketës fiskale me një incentiv të tatimit mbi fitimit nga 15% në 5% për një arsye të thjeshtë: sot në Ballkanin Perëndimor jemi ndër vendet e fundit, që nuk e kemi incentivuar akoma këtë industri, ndërkohë që ky rajon është kthyer në vëmendjen e shumë investitorëve të huaj për të zhvendosur nga vendet e tjera fabrikat e tyre të *manufacturing*, si Serbia, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi. Shqipëria mund të përfitojë nga tërheqja e investitorëve të huaj. Ne kemi pasur dy kërkesa nga kompani të huaja, që presin një incentivë fiskale, madje dhe vetë klima e përgjithshme e biznesit në Shqipëri bën të mundur instalimin e fabrikave të tyre në Shqipëri dhe në projeksionet e tyre të kenë mundësinë të rrisin punësimin me të paktën 5000 vende pune në 5 vitet e ardhshme, flas për një kompani japoneze, e cila është shumë e njohur në Shqipëri dhe jo vetëm. Është nevojë që të jemi përkrah të gjitha vendeve të tjera të rajonit kur vjen puna e adresimit të incentivave të industrisë automative.

Për sa i përket strehimit, nevojave sociale dhe nxitjes së komuniteti rom, jo vetëm drejt politikave sociale, por edhe drejt punësimit, unë do të kërkoja që zonja Dhëmbi të japë dy komente në raport me politikën e strehimit, por më lejoni të them që komuniteti rom, në të gjithë treguesit që lexojmë, ka pasur së fundmi një rritje të konsiderueshme të arsimit parashkollor në krahasim me vitet e mëparshme dhe falë një politike përfshirjeje, e cila mund të konsistojë në të dëgjuarit më shumë, sikurse e përmendi zoti deputet. Në nivel të qasjes së masave të ndërmarra, ne kemi rritur nivelin e arsimit parashkollor në këtë komunitet, gjë që është një tregues shumë i rëndësishëm për tërheqjen e fëmijëve nga rruga drejt arsimit. E njëjta gjë është edhe për komunitetet me ndihmë sociale. Ligji i nxitjes së punësimit, i cili u aprovua në parlament në muajin maj të këtij viti, kërkon të ndihmojë disa shtresa drejt punësimit dhe jo vetëm drejt aspektit social, sikurse janë personat me aftësi të kufizuara, të cilët, për arsye të parashikimeve ligjore, mund të kenë një hapësirë më të gjerë në punësim sesa kanë pasur në vitet e mëparshme.

Për sa i takon qendrës në Lushnje, por edhe rastin e Fierit, unë mendoj se bashkia duhet ta shohë këtë qasje në fondet e tyre të shpenzimeve, pasi është e vërtetë që fillojnë me fondet e donatorëve. Gradualisht donatorët dalin për t'ia lënë këtë një politike të qëndrueshme të pushtetit

vendor, por nuk mund të jetë gjithmonë pushteti qendror ai që mbështet, kur vetë bashkia lokale duhet të vendosë në projektionin e saj afatmesëm se si të qasë këtë grup.

Ne jemi angazhuar si në rastin e Fierit, ashtu dhe në rastin e Lushnjës të shohim që, për sa kohë nuk bëhet fjalë për një fond të konsiderueshëm, ta adresojmë brenda një analize, që do të na vijë nga komuniteti.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E rëndësishme është që bashkitë ta shohin këtë si një rol të tyre.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne flasim me projeksione, kështu që do të ishte mirë që edhe bashkia t'i shihte kështu, megjithatë, për sa kohë bëhet fjalë vetëm për dy zona, Fieri dhe Lushnja, ne kemi marrë angazhim që do t'i shohim dhe do të kemi mundësi që nëpërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ta adresojmë.

Zoti kryetar, kam një problem. Paralelisht ne duhet të shkojmë edhe Komisionin e Ekonomisë, ku do të flasim për shpenzimet, por jemi të gatshëm që të lëmë këtu një ekip teknik dhe të vazhdojmë me një ekip tjetër. Nuk e di si e gjykoni!

Niko Peleshi – Dakord, vetëm nëse ne nuk do të marrim dot përgjigje për pyetjet tona nga ekipi teknik, do t'ju thërrasim përsëri.

Nëse keni një agjendë tjetër do t'ju thërrasim në një takim tjetër, nëse nuk do t'i shterojmë dot me ekipin.

Na jepni një datë tjetër për dëgjuesë, nëse nuk do të jenë shteruar pyetjet tona nga përgjigjet e stafit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani nuk është kohë pushke, por kohë pene.

Unë nuk mora përgjigje për asnjë nga pyetjet e mia, por jam oportunist, kështu që nuk ka problem.

Anila Denaj – Në raport me Qafë Plloçën, në komunikim me ministrinë përgjegjëse, ne jemi duke saktësuar vlerën totale të projektit për disa arsye, sepse për të vlerësuar mbështetjen me financim të huaj, se ne e dimë që ky projekt bëhet me financim të huaj, duhet të ishte e saktë për të përfunduar këtë rrugë dhe nuk kemi arritur akoma në një konkluzion se sa do të jetë kjo vlerë për të vijuar më tej me kërkesën shtesë.

Niko Peleshi – Mos e bëj këtë pyetje, se do të bëj unë pyetjen tjetër! Sa humbet çdo ditë nëse lihet kantieri hapur?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, se pastaj vjen pyetja e dytë më kritike.

Anila Denaj – Unë nuk e kam tani shifrën, megjithatë mund të them që shuma është e konsiderueshme dhe kjo është një nga arsyet pse komunikimi po ndodh mes dy ministrive.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Fol, se mbledhja nuk është mbyllur!

Unë nuk e mbaj dot me zor ministren në komision, po të doni e mbyllim këtu dhe e vijojmë komisionin me prezencën e ministres.

Anila Denaj – Është e nevojshme që ne t'i kemi pyetjet dhe përgjigjet do të jenë shteruese edhe me shifra konkrete si për rrugën Qafë Plloçë, apo me çdo rrugë tjetër. Nëse i marrim sot disa nga këto pyetje ne të kemi mundësi t'u japim përgjigje të paktën deri nesër në mëngjes me shkrim.

Niko Peleshi – Ju lutem, na jepni një orar për një takim tjetër kur të vijmë përgjigjet e pyetjeve dhe të kemi minimalisht mundësinë që relatori i projektbuxhetit të flasë para jush.

Anila Denaj – Caktimin e orareve në komisione duhet ta ketë dikush në përgjegjësi, sepse edhe kjo është një situatë e panevojshme mes dy komisioneve. Unë, në respekt të detyrës sime dhe të komisionit do të doja të qëndroja më shumë, por me duhet të shkoj në një komision tjetër për shpenzimet, kështu që e kam të nevojshme të vendosim si do të procedojmë. Ne mund të vijmë edhe një ditë tjetër, por kolegët e mi do të qëndrojnë dhe nesër do të sjellim edhe përgjigjet e tjera.

Niko Peleshi – Dakord.

Shumë faleminderit për përgjigjet dhe kohën!

Anila Denaj – Faleminderit!

Niko Peleshi - Po, zoti Lera.

Nikolla Lera – Lidhur me tatimin mbi vlerën e shtuar dhe me problematikën në rimbursimin e TVSH-së, i cili ka qenë objekt diskutimi dhe shqetësim për të gjithë deputetët e këtij komisioni, por edhe për operatorët ekonomikë sqaroj: në janar të vitit 2019 stoku i kërkesave të miratuara të rimbursimit ka qenë 16,8 miliardë lekë. Ju e dini që kemi pasur presione, kërkesa legjitime nga biznesi, i cili vonoi në rimbursimin e TVSH-së. Kemi hartuar një

plan të detajuar dhe në fund të vitit 2019 stoku i rimbursimeve do të ulet me 10% krahasuar me fillimin e vitit 2019, ndërkohë që rimbursohen 19 miliardë lekë nga 14,4 miliardë lekë. Fundi i vitit 2019 me fillimin e tij reduktohet me 10%.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Janë shlyer 19 miliardë lekë ose rreth 90% e TVSH-së korrente të kërkuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, sepse e kërkuara është më e madhe se ajo që rimbursohet, ndërkohë që e kërkuara është zakonisht rreth 10%-15% më e lartë se ajo që miratohet, sepse ka fatura dhe lloje furnizimesh, të cilat pas verifikimit nuk konsiderohen si rimbursim ligjor. Ne do të ulim stokun e rimbursimeve në vitin 2019 me 10%, duke rimbursuar 19 miliardë lekë, dhe kjo është plus 32% më shumë se në vitin 2018, kur kemi rimbursuar 14,2 miliardë.

Në vitin 2020 do të rimbursojmë 21 miliardë lekë, në fund të vitit 2020 stoku do të jetë vetëm 4,5 miliardë lekë dhe në qershor të vitit 2021 stoku do të jetë zero. Çfarë dua të them? Ne kemi adresuar pjesën më të madhe të kërkesave për rimbursim. Dua t'ju informoj se kërkesat që vijnë nga tatimpaguesit e vegjël, që janë problematike me TVSH-në, se u nevojitet, siç janë eksportuesit, fasonët etj, kemi arritur t'i rimbursojmë me vonesë 13 deri në 15 ditë nga kërkesa e tyre e miratuar. Ky afat nuk është zbatuar asnjëherë nga administrata tatimore.

Thashë që në fund të vitit 2019 do të kemi një stok rreth 15,4 miliardë lekë, por duhet të kuptojmë që 90% e këtij stoku është vetëm e TAP-it me të cilin ne kemi dhe do të kemi skemë për pagesë me këste të shtrirë në një vit e gjysmë kohë, që do të thotë se pjesa tjetër e parimbursuar që i takon tatimpaguesit.....

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sikurse e thashë ky stok do të jetë 15,4 miliardë në fund të vitit 2019, nga e cila 85% i takon TAP-it dhe 5% është e një subjekti tjetër, që ndërton HEC-e. Me këtë dua të them se pjesa e tatimpaguesve të vegjël, apo të mesëm, që ka ngelur për t'u rimbursuar, është shumë e vogël.

Niko Peleshi – Sa është në total, duke hequr TAP-in?

Nikolla Lera – Në 15,4 miliardë lekë që do të ngelen në fund të vitit 2019 90% e saj, pra rreth 13,5 miliardë lekë, është TAP-i dhe AIEM-i.

Niko Peleshi – Domethënë më pak se 10 milionë euro është borxhi?

Nikolla Lera – Pjesa tjetër që adresohet brenda 4-5 muajve të parë të vitit 2019 dhe TAP-in do ta mbyllim në qershor të vitit 2020, me shtrirjen dhe pagesat me këste që do të bëjmë.

Ne e kemi mbyllur përfundimisht kapitullin e vonësve të tejskajshme në rimbursimin e TVSH-së së subjekteve. Është pozitiv fakti që ne do të rimbursojmë 22 miliardë lekë në vitin 2020, që janë rreth 13-14% të tatimit mbi vlerën e shtuar që mbledh ky shtet. Pra, nga 7%-8% që rimbursnin para 7-8 vjetësh, rimbursojmë dyfishin, pra 14% të TVSH-së totale që grumbullohet. Ky është një përmirësim i ndjeshëm në kërkesat për rimbursim, në miratimin e tyre dhe në rimbursimin faktik për tatimpaguesit.

Për pyetjen e tatimit mbi të ardhurat dhe efektin e taksës progresive, që u implementua në ...

Niko Peleshi – Pyeta specifikisht për TAP-in.

Nikolla Lera – Dakord.

Të ardhurat personale:

Në vitin 2017 ne kemi arkëtuar 32 miliardë lekë; në vitin 2018 kemi arkëtuar 36,5 miliardë lekë; në vitin 2019 presim të arkëtojmë rreth 47,8 miliardë lekë.

Në vitin 2019 ne kemi efektin *one-of* të tatimit mbi dividendin. Ju jeni në dijeni që parlamenti e reduktoi tarifën e tatimit mbi dividendin në paketën e fundvitit të kaluar, nga 15% në 8%, dhe kjo incentivë çliroi një masë të madhe të fitimit mbi tatimin, qoftë të kapitalizuar, të mbajtur në formën e rezervave apo në formën e fondeve për investim nga tatimpaguesit.

Nëse në vitin 2018 nga taksa mbi dividendin ne kishim arkëtuar 3,5 miliardë lekë, në vitin 2019 arkëtuam 11,2 miliardë lekë, rreth 7 e ca miliardë lekë më shumë.

Në vitin 2020 ne planifikojmë që taksa mbi dividendin të jetë rreth 4,5-5 miliardë lekësh. Pse? Ne kemi arkëtuar 3,5 miliardë lekë në vitin 2018 në vitet e kaluara, sikurse e thashë, me tarifën 15%. Ulja e tarifës përveçse ndikoi në vitin 2019, në kuptimin e *one of*, duke arkëtuar 7 miliardë lekë, do të impaktojë edhe vitin 2020, sepse shpërndarja e dividendit nuk do të jetë në përmasat që bëhej në vitet 2016-2017-2018 e më parë, por në përmasa më të mëdha, ndaj kemi planifikuar që nga 3,5 miliardë lekë të kalojmë në 4,5-5 miliardë lekë, që do të thotë se politika për uljen e dividendit ka stimuluar shpërndarjen dhe konsumin e fitimit në bazë të tatimit.

Niko Peleshi – Çfarë i ngelet TAP-it po të heqim efektin e dividendit? Si ka shkuar nga periodha para taksës progresive, kur kishim taksën e sheshtë e më pas dhe si është trendi?

Nikolla Lera – Tatimi mbi të ardhurat personale ka qenë 21 miliardë lekë në vitin 2014; 30 miliardë lekë në vitin 2015, 31 miliardë lekë në vitin 2016, 32 miliardë lekë në vitin 2017, 36,5 miliardë lekë në vitin 2018 dhe 42 miliardë lekë në vitin 2019.

Niko Peleshi – Këtu përfshihet edhe dividendi?

Nikolla Lera – Po.

Edhe po ta zhveshim vitin 2019 nga 7 miliardë lekë dividend, në kuptimin e *one-of-it*, trendi është pozitiv dhe është në rritje normale 5, 6%-7%.

Niko Peleshi – Sa ka qenë në vitin 2013?

Nikolla Lera – Në vitin 2013 kemi arkëtuar 29,6 miliardë lekë mbi të ardhurat personale nga tatimi. Duhet të kemi parasysh se ndryshimi i skemës, nga skemë fletë, taksë e sheshtë 10%, në tarifë progresive për tatimin mbi të ardhurat personale nga paga, ka dhënë një impakt negativ në buxhet me rreth 5 miliardë në vit. Ne e kemi thënë shumë herë se kjo qeveri vendosi të mos ia linte buxhetit të shtetit 5 miliardë lekë, por t'ua linte arsimtarëve, policëve, mjekëve, infermierëve e të tjera.

Niko Peleshi – Këtë doja të dija.

Nikolla Lera – Buxheti i shtetit ka pasur impakt negativ nga aplikimi i taksës progresive në tatimin mbi të ardhurat personale nga paga, që është llogaritur rreth 5 miliardë lekë për vitet 2014, 2015, 2016. Po të bëhen kalkulimet sot, është më i lartë se aq.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Besoj se nuk kemi pyetje të tjera pa përgjigje, sepse është përgjigjur ministria dhe përfaqësuesi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Relatori mund t'i bashkojë pyetjet, komentet dhe diskutimet.

Ilir Beqaj – Nëse do të përpiqesha të thosha vetëm një fjali, në përpjekje për t'i gjetur një emër buxhetit të këtij viti, siç duhet t'i gjejmë çdo vit, do ta quaja “buxhet prudent”. Do të doja të ishte më agresiv, por qeveria vjen me tri synime kryesore.

E para, nuk do të bëjë politika të reja fiskale, se ne kemi bërë vit pas viti politika, por ndoshta ka ardhur momenti të bëjmë një analizë disavjeçare të impaktit që kanë pasur politika të caktuara, për të parë se cila prej tyre ka qenë aq efektive, sa e kemi menduar fillimisht, dhe cila ka nevojë të rishikohet, meqenëse fjala “revizionim” duket jo shumë e përshtatshme.

E dyta, përtej ambicieve tona si maxhorancë dhe përtej nevojave të biznesit, u pa dhe çfarë bëmë vitin e kaluar, që bizneset, më shumë se politika të reja, duan edhe qëndrueshmëri. Ne bëmë shumë debate për taksën e plastikës dhe më pas na u desh ta rishikonim.

Ka shumë debate edhe për skemën e rimbursimit të TVSH-së në bujqësi. Këtë vit eksportuesit janë të kënaqur, ndërsa fermerët janë disi të pakënaqur, ndaj qeveria ka menduar të jetë prudente në mënyrë që edhe politikisht të punojë shtruar gjatë vitit 2020 për të dalë në vitin 2021, edhe në prag të zgjedhjeve të reja parlamentare, me propozim për një program të konsoliduar disavjeçar.

Së dyti, mendoj se është treguar prudente në drejtim të rregullave fiskale, që do të thotë se vazhdon me balancë primare pozitive, vazhdon të ulë borxhin në përqindje ndaj produktit të brendshëm bruto, vazhdon të mos e shfrytëzojë të gjithë hapësirën që i jep rregulli fiskal për PPP-të me financim buxhetor. Ne kemi një rregull në ligjin normativ të buxhetit, që këto nuk mund të jenë më shumë se 5% e të ardhurave të viteve të mëparshme, dhe u tha se janë 3%. Pra ka shfrytëzuar vetëm 60% të hapësirës që i jep rregulli fiskal për PPP-të me financim publik. Megjithatë, sërish synon një rritje ekonomike mbi 4%, 35 mijë vende të reja pune dhe mendoj se vazhdon në mënyrë të shënjestruar të prekë disa çështje për sa u përket sektorëve të ekonomisë, për të cilat ne jemi edhe më shumë përgjegjës si komision, si: bujqësia, zhvillimi rural, infrastruktura, energjia.

Mendoj se investimet publike duhen trajtuar në mënyrë më të thellë, sidomos për sa u përket kostove të shpronësimeve. Do t'i propozoja Ministrisë së Financave që vitin e ardhshëm, për çdo investim të ri publik, kryesisht në infrastrukturë, ku si gjithmonë ne parashikojmë fonde për projektim, fonde për zbatim punimesh, për mbikëqyrje punimesh dhe për kolaudim, të shtojë edhe një element të pestë që në fillim, për shpronësimin, që kur të bëjmë një vlerësim të plotë sa na kushton një vepër publike, përfshirë edhe në studimet e fizibilitetit, të kemi parasysh edhe çështjen e shpronësimeve, jo vetëm kontabilist. Ai sërish është investim kapital dhe kontabilizohet si aset, por edhe për faktin se do të jemi shumë më të saktë në zbatimin në kohë të kontratave dhe do të evitojmë shumë probleme sociale dhe politike, që krijohen nga kjo gjë. Kemi një vit që po vonohemi me Unazën e Tiranës. Nëse masim vetëm me para se sa kohë ka humbur çdo automjet vetëm me këtë vit vonesë për fillimin e veprës, është Besniku këtu, që është shumë i ndjeshëm, sa CO2 është emetuar më shumë në mënyrë të panevojshme në mjedis, i cili kthehet edhe në kuota të energjisë, del shumë më tepër kosto sesa të ishim shënjestruar saktë që në fillim të shpronësimi. Po e sjell si ilustrim, sepse shpeshherë shpronësimet kthehen në vonesa të veprave dhe krijohen konflikte mes zbatuesit të punimeve, të cilit kemi për detyrë që kantierin t'ia lëmë sa më të pastër.

Buxheti fillon të jetë më aktiv edhe në infrastrukturën e transportit, jo vetëm rrugor, sepse themi rrugë, rrugë, por mallrat lëvizin edhe me hekurudhë, edhe me det. Më në fund është aktiv edhe në industrinë e detit, që ndoshta është potenciali më i fjetur që kemi ende në ekonominë tonë. Vazhdojnë mbështetjet në bujqësi, edhe pse thelbi i mbështetjes drejtpërdrejt në bujqësi mbetet instrumenti i IPARD-it dhe, nëse stabilizojmë skemën e rimbursimit të TVSH-së, duke harmonizuar interesat e fermerit të vogël apo atij me fermë të vogël, me grumbulluesin dhe eksportuesit, do të kemi një situatë më normale.

Lajm shumë i mirë në relacion është përpjekja për stabilizim të rimbursimit të TVSH-së, sepse u krijon qetësi dhe largpamësi operatorëve ekonomikë. Nëse bëjmë një krahasim me vitin 2013: GDP-ja për banor rritet me 52% në 7 vjet, ndërkohë që borxhi publik për banor, në vlera absolute, rritet me 38%. Nëse ka njerëz, të cilët na akuzojnë që jeni rritur duke marrë borxh, ne jemi rritur më shumë se sa kemi marrë borxh. Rishpërndarja mbetet sfidë. Si është shpërndarë aritmetika 52% për banorë? Ka një perceptim, që në këto vite Shqipëria është polarizuar. Në gjykimin tim, perceptimi është i pambështetur, ndërsa e kundërta është e vërtetë.

Për anketën e buxheteve familjare, kemi një seri kohore të konsoliduar prej 5 vjetësh: gjatë viteve 2014, 2015, 2016, 2017, 2018 tregon se konsumi mesatar i familjeve shqiptare është rritur me 10%. Mediana, që ndan të pasurit dhe të varfrit në konsum, është rritur shumë më tepër, që do të thotë se krahasimisht shtresat më të varfra konsumojnë më shumë, me ritëm më të lartë, edhe pse konsumi i tyre është ende jo i ndjeshëm në krahasim me të gjithë konsumin, por fakti që gjithë këto vite zëri hotel-restorante, që sigurisht është kontribut edhe nga turizmi, por i brendshëm, është rritur më shumë se shpenzimet e arsimit, të akomodimit dhe të shëndetësisë, tregon për një tendencë pozitive të përmirësimit të konsumit masiv të popullsisë. Hotelet dhe restorantet e Shqipërisë nuk i mbushin dot një tufë oligarkësh, që na akuzojnë se janë 5 familje. 5 familje nuk mund të mbushin të gjitha hotelet dhe restorantet e Shqipërisë, nga Valbona në Sarandë.

Unë me Nikon, ai e ka për detyrë, ndërsa unë si për orë jashtë klase, bëjmë shpesh analiza afatgjatë, dhe del se fitimi i 10 kompanive më të mëdha në Shqipëri, në peshën zë ndaj fitimit të të gjithë kompanive shqiptare, ka qenë 37% në vitin 2013 dhe në 22% ka rënë në vitin 2017, sepse vitin 2018 nuk e kemi parë ende. Fitimi i të gjitha kompanive është rritur. Nëse norma e fitimit u rrit nga 10%, në 15%, dhe të ardhurat do të rriteshin me 50%, janë rritur me 95%. Kompanitë e mëdha, edhe pse iu rrit fitimi, fituan më shumë. Kjo ndoshta nga dividendi i

pashpërndarë dhe i shpërndanë masivisht këtë vit, në bazë të lehtësirës fiskale me efekt prapaveprues, për të cilin kemi pasur shumë debate pro dhe kundër. Në këtë kuptim, edhe pse personalisht do të kisha dashur të ishte një buxhet më agresiv, le t'ia lëmë qeverisë agresivitetin për vitet 2021-2023, që do të jetë edhe programimi i mandatit tonë të ardhshëm qeveritar.

Zoti kryetar, nëse më lejohet, dua të bëj edhe 2-3 pyetje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit!

Kjo pyetje ka të bëjë më shumë me tekstin e nenit 17. Pse lind nevoja të përcaktohet 37,3? Përse duhet të përcaktohen në buxhetin e vitit 2020 koncesioni i Aeroportit të Rinasit, koncesioni i pasaportave biometrike, koncesioni i markimit të karburantit, koncesioni i kontrollit të automjeteve, që pritet të mbarojë, të cilat praktikisht, nuk janë PPP që marrin mbështetje buxhetore? Po të ishte 150% kjo, cila do të ishte e keqja? Unë e kam bërë një debat me përfaqësuesit e financave që kur fillova PPP-të në shëndetësi. Nuk ka asnjë arsye që PPP-ja e dializës të jetë këtu, sepse, nëse e anulojmë nesër, ne paguajmë drejtpërdrejt privatin me kontrata 1-vjeçare dhe jo me kontrata 10-vjeçare. PPP-ja e dializës, pas 7 vjetëve që mbaron kontrata, i ngelet spitalit, po ta heqim nga PPP-ja dhe të rrimë në shpenzime, që ne ia japim me taksat e shqiptarëve privatit, nuk marrim asgjë pas ca vitesh. Përse u dashka që këto kontrata, me këtë profil, të vijjnë në këtë nen. Pse duhet të jenë kusht apo rregulli i vitit 2020, për pasojë edhe i vitit 2021?

Meqenëse edhe ministria për një kohë të shkurtër, dhe unë disa vite më shumë, kemi punuar në shëndetësi, pse tavani i rimbursimit të barnave të neni 5 duhet të përfshijë edhe të prapambeturat? Nëse ka të prapambetura, laje, sepse më duket sëprapthi që hyjmë në një vit të ri dhe i themi se ke këtë kufizim të ri bashkë me të prapambeturin. Nëse ka të prapambetur, zeroje. Më mirë lëmë diçka pa bërë, sepse në shëndetësi ka disa projektet të tjera. Të prapambeturat krijojnë probleme në të gjithë zinxhirin e tregtimit të barnave, sepse pacientët i kanë marrë barnat, depot i kanë furnizuar farmacitë dhe farmacitë kanë dhënë dhe aq xhiro bëjnë në vit.

Niko Peleshi – Po, zonja Dhëmbi.

Mimoza Dhëmbi – Dy çështjet që ngriti zoti Beqaj. Në momentin që është miratuar amendimi i ligjit të ri të buxhetit, është përcaktuar një detyrim, që në ligjin vjetor të buxhetit të shtetit paraqitet totali i kontratave koncensionare dhe PPP-të bashkë, me vlerën e plotë të kontratave ekzistuese dhe kontratave të miratuara rishtazi gjatë vitit buxhetor. Ky është detyrim i

ligjit organik të buxhetit të ri. Ideja ka qenë për transparencë, prandaj ne do të publikojmë një listë me të gjitha llojet e koncesioneve, pavarësisht nëse kanë mbështetje buxhetore apo jo për të treguar edhe madhësinë e kontratave, në raport me ekonominë shqiptare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në mënyrë që ta shikojë i gjithë populli.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Regjistrin nuk e shikon njeri, kurse, kur miratohet buxheti, transparenca është shumë më e hapur, ndërkohë bën edhe lidhjet me pagesat vjetore që ka buxheti e të tjera. Pra, është momenti që të bëjmë transparencë të plotë. Pra, ky ka qenë qëllimi dhe ajo tregon madhësinë e kontratave që kemi sot.

Në lidhje me tavanin e rimbursimit të medikamenteve...

(Diskutime pa mikrofon)

Kemi dy vjet që ne kemi vendosur një tavan për shpenzimet e rimbursimit, sepse shpenzimet e rimbursimit u rritën në përpjesëtime të mëdha ndër vite. Domethënë, filloi me ritme të shpejta të rritej tavanin për rimbursimin e medikamenteve. Kështu, me qëllim kontrollin ose disiplinimin e këtij lloji shpenzimi, ne vendosëm një tavan në ligjin e buxhetit. Unë kam përshtypjen se këtë gjë ne e vendosëm vjet për herë të parë. Ne kemi rënë dakord që çdo politikë e re do të bëhet brenda tavanit 10,5 miliardë.

Ilir Beqaj – Por ka detyrime të prapambetura.

Mimoza Dhëmbi – Pse ka detyrime të prapambetura? Detyrime të prapambetura ka, sepse skema dhe tavanin nuk janë respektuar.

Ilir Beqaj – Pse e keni përfshirën këtë tavan për vitin 2020? Ndajeni dhe lëreni të lirë për vitin 2020.

Mimoza Dhëmbi – Edhe për vitin 2019 ne e kemi rritur tavanin. Ne e dimë se kemi 900 milionë detyrime të prapambetura. Në qoftë se e vutë re, në aktin normativ ne e kemi rritur tavanin dhe e kemi bërë 11 miliardë, në mënyrë që të shlyhet një pjesë e detyrimeve të prapambetura dhe pjesa tjetër e mbetur është 10,5 plus 500 të tjera. Kjo është ideja, por, nëse ata kanë mundësi ta shlyejnë, duhet që ne ta ndryshojmë tavanin e vitit 2019.

(Diskutime pa mikrofon)

Ideja është që ata ta kuptojnë se ky tavan është bashkë me detyrimet, pra nuk ka ndryshuar vlera 10,5 miliardë. Kjo është çështje discipline.

Ilir Beqaj – Atëherë, le ta lajmë detyrimin, në mënyrë që të mos hyjmë edhe në vitin 2020 me detyrime.

Mimoza Dhëmbi – Kjo bëhet nëse kanë mundësi. Në momentin që ne kemi bërë buxhetin, kishin mundësi të shlyenin vetëm 500 milionë lekë. Kështu, në qoftë se ata do të gjejnë mundësi të tjera, kur ne të bëjmë aktin normativ do ta ndryshojmë, ndërkohë do t'ua lemë tavanin 11 miliardë për vitin tjetër.

(Diskutime pa mikrofon)

Lidhet pra, sepse detyrimi i prapambetur që kemi sot ka një stok, i cili duhet eliminuar. Ky është qëllimi.

(Diskutime pa mikrofon)

Tavani i vitit 2019 dhe tavani që kemi vendosur për vitin 2020 e zeron detyrimin e prapambetur për medikamentet.

Niko Peleshi – A ka diskutime të tjera?

Po, zoti Gjuzi.

Kujtim Gjuzi - Faleminderit, zoti Kryetar!

E falënderoj administratën, që ka ardhur sot për buxhetin. Para se të filloj një diskutim makro, dua të bëj disa pyetje. A ka ndonjë informacion Ministria e Financave që në tregun financiar shqiptar fajdexhinjtë, studentët, arrijnë deri atje sa hidhen nga pallati, sepse nuk kanë asnjë lloj mundësie që të shlyejnë fajdetë?

Së dyti, çfarë do të bëni me kreditë e këqija të bankave, të cilat nga 23%, që ishin vjet, kanë shkuar në 26 apo 27%? Çfarë masash janë marrë në zinxhirin financiar, se këtu shikoj vetëm një përsëritje të buxhetit me pak rregullime? Pyetja më e rëndësime, ndoshta nuk vlen vetëm për ju, por do ta them: kanë kaluar shumë vjet dhe ende nuk ka një amnisti fiskale, ndërkohë që në që flasim kemi 33 mijë biznese të falimentuara gjatë qeverisjes suaj.

Zoti Kryetar, nëse do t'u duhet kohë që të më japin një përgjigje, se nuk i kanë të gatshme, a mund ta vazhdoj me diskutimin?

Niko Peleshi - Patjetër!

Kujtim Gjuzi - Faleminderit, zoti Kryetar!

Si deputet i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, mendoj se sistemi financiar ka pasur një përqaasje pozitive, e cila ishte...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ja sa të mbarojë Iliri! Ai është gati të bëhet ministër i Financave në qeverinë akademike, se është akademik tjetri.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ti dua që, kur të flas, të më dëgjosh, ndryshe mund të hesht.

(Diskutime pa mikrofon)

Unë po them se çfarë thotë guvernatori i bankës, kurse ti më thua mua se çfarë thotë letra këtu. Unë them çfarë ka brenda, se është 27% tani që flasim bashkë.

I nderuar zoti Kryetar, dua të sjell në vëmendje se pardje në zyrën time erdhi një familje, e cila kishte rënë pre e skemës financiare mafioze të një kompanie në Tiranë. Unë, kur flas, kam një garant nga pas.

Niko Peleshi – Dakord, por ne flasim me shifra zyrtare.

Ilir Beqaj – Ndonjëri mund të kalojë me të kuqe në semafor, duke e ditur se kalohet me jeshile, çfarë do të thotë kjo?

Kujtim Gjuzi - Zoti Beqaj, a ka mundësi të mbaroj, sepse kam respekt për ty, se jemi kolegë bashkë.

Unë kam dëshirë që të më dëgjojë edhe administrata, sepse unë edhe mund të hesht.

Niko Peleshi – Vazhdoni, zoti Gjuzi.

Kujtim Gjuzi – Pra, në këtë koncept ne kemi përgjegjësi, pasi kemi sjellë komisionin dhe Kuvendin në parametra intelektualë. Administrata e shtetit duhet të hapë dyert për të përndjekurit politikë, sepse ju nuk i prisni, nuk u jepni paratë, sepse paratë aty i keni. Pse nuk e bëni?- është pyetja tjetër. Pse i zvarrisni? Pse ju, kur keni, siç thoni këtu, rritje të mbledhjes së të ardhurave, dhe është e vërtet që i keni? Një kolegu ynë thotë: “Keni shkopin dhe karrotën”. Vërtet ashtu është se në fillim duhet karrota dhe më pas shkopi, në qoftë se ai nuk i paguan. Pse ju u mbani para minatorëve dhe profesioneve të vështira, ndërkohë që shpenzoni më shumë për luksin. Ministria e Financave ia kalon edhe Bashkisë së Vjenës për luks dhe për këtë të sigurt, të nderuar kolegë.

Kryetari na ka dhënë fjalën se do të na çojë në Vjenë për një vizitë dhe shpresoj që i gjithë komisioni të shikojë, se Ministria e jonë e Financave është e restauruar dhe e zbukuruar me luks të paparë më shumë se Bashkia e Vjenës. Paratë nuk janë tuajat, prandaj unë do t’ju këshilloja si kolegë të bëni kujdes me financat. Normalisht, ne ekonomistët e mbrojmë njëri-tjetrin në çdo vend, edhe kur jemi në kundërshti, sepse jo gjithmonë ne jemi në avantgardë. Në

fakt, pa ekonomi dhe pa para, askush nuk mund të bëjë politikë. Në këto kushte, amnistia fiskale duhet të përgatitet nga ju. Në qoftë se ju nuk e përgatisni dhe vini në seancën e radhës për këtë buxhet, po ju them se vota ime nuk do të jetë kundër, si pasojë e të qënurit kolegë, por abstenimin e keni të sigurt. Nëse ne abstenojmë, përgjegjësia është edhe juaja. Pse të mos e merrni votën tonë pro? 104 vota kishte gjithsej parlamenti, sepse donim një projektrezolutë dhe 97 vota ishin pro që të votohej ajo projektrezolutë. Zoti Kryetar, unë abstenoja, por dikush tjetër votën e time e nxjerr pro dhe më pas njerëzit në rrugë dhe më thanë: “Çfarë ke bërë kështu? A je, apo nuk je opozitë?!” Po ku keni parë opozitë më komode se ne, zoti Kryetar! Këtu e kam fjalën për grupin që konsiderohemi opozita e re, se unë, në fakt, jam opozitë e vjetër në këtë vend. Prandaj, do t’iu lutesha përfaqësuesve të Ministrisë së Financave, sepse unë nuk lutem lehtë, por, përderisa kemi dy zonja dhe dy zotërinj, në respektin tuaj, që ta rishikoni çështjen e amnistisë fiskale. Të gjitha paratë janë jashtë sistemit të buxhetit të shtetit, ju këtë e dini më mirë se sa unë. Po të doni, mund t’ju provoj edhe këtu në këtë komision që sa prej nesh i marrin paratë me kartë dhe sa pa kartë. Një kolegu im më tha një ditë: “Si nuk më ke dhënë një herë 100 euro? Po si t’ia jap, sepse më duhet t’ia jap nëpërmjet sistemit financiar. Pra, t’i heq nga llogaria ime dhe t’ia kaloj te llogaria e tij. Pra, të gjitha paratë janë në sistem. Atij i mbeti hatri, por...

Niko Peleshi – Racionohuni pak.

Kujtim Gjuzi – A do të mbash rregull, zoti Kryetar, se duhet ta raportoj menjëherë këtë, se është hedhur një studente nga pallati për 34 mijë lekë të vjetër.

Niko Peleshi – Ti do që të kapësh lajmin tani? Pra, do të kapësh lajmin nga gjithë ky takim, duke e bojkotuar? Ju keni shumë të drejtë, por, ju lutem, kujdes me kohën!

Kujtim Gjuzi – Vendorsni një limit.

Niko Peleshi - Nuk ka limit, është çështje etike e pranuar.

Kujtim Gjuzi – Atëherë, ju doni që ta mbyll fjalën?

Niko Peleshi – Jo, mund të vazhdoni, por tregohuni pak sintetik.

Kujtim Gjuzi – Meqenëse kryetari i komision kërkon që ta mbyll fjalën time, sepse unë do të kisha vazhduar më shumë, dua t’ju them vetëm një gjë: në qoftë se, nëpërmjet intonacionit, unë përdora faktin e të qënurit deputet, nuk është e vërtetë. Unë jam i barabartë me ju, të nderuar kolegë, dhe nëse duam të bëjmë një buxhet të mirë si asnjëherë tjetër, le ta fillojmë me amnisti fiskale. Si mendoni ju? Kjo ishte pyetja ime kryesore.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Zoti Baraj kërkon të bëjë një ndërhyrje. Më pas fjala është për zotin Çaçani dhe më pas për ministren ose përfaqësuesit e ministrisë.

Besnik Baraj – Meqenëse jam shumë dashamirës me kolegun Gjuzi, i cili në përgjithësi ka një formim historik, që vërtet më surprizën, dua thjesht ta informoj se Ministria e Financave është rinovuar në vitin 2004-2005 dhe kjo qeverisje nuk ka asnjë rol në shkallën e luksit, apo ku di unë. Në atë kohë ajo ka qenë Ministria e Mbrojtjes, më vonë është bërë Shtabi i Përgjithshëm dhe tani është Ministria e Financave.

(Diskutime pa mikrofon)

Niko Peleshi – Patjetër!

Ti e di që ne jemi komisioni më demokratik në Kuvend.

Kujtim Gjuzi – I nderuar profesor Baraj, me gjithë konsideratën e lartë që kam për ju, po të jetë puna për miqësi, unë e kam më afër mbiemrin me ministren.

(Diskutime pa mikrofon)

Niko Peleshi –Po, zoti Çaçani.

Arlind Çaçani – Faleminderit, zoti Kryetar!

Si deputet i qarkut të Korçës dhe si përfaqësues i Kolonjës, dua t'i bëj një pyetje ministres: çfarë keni parashikuar në buxhetin e vitit 2020 për aksin rrugor Korçë –Ersekë, që ka mbetur në mes nga Qafa e Qarrit deri në qytetin e Ersekës? Për këtë aks rrugor ka rreth 6 vjet që është bërë loti i parë dhe loti i dytë ka mbretur në vend. Në qytetin e Ersekës dhe në Kolonjë nuk kanë asnjë rëndësi investimet e tjera, pa u përfunduar kjo rrugë, qoftë për agroturizmin apo shumë gjëra të tjera. Unë dua një përgjigje: a është parashikuar në buxhet vazhdimi i lotit të dytë?

Faleminderit!

Niko Peleshi – Po, zonja Ministre.

Anila Denaj - I nderuar zoti Kryetar,

Të nderuar deputetë,

Kërkoj ndjesë për mungesën time për pak minuta.

Më lejoni t'i jap një përgjigje zotit Beqaj në kontekstin e kërkesave apo komenteve të tij në raport me publikimet, të cilat janë detyrim ligjor i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për të gjitha PPP-të. Pavarësisht nëse ato janë të mbështetura me fonde buxhetore apo jobuxhetore, kjo për të rritur transparencën por edhe në mbështetje të akteve ligjore, të cilat për ligjin e

buxhetit janë taksative për Ministrinë e Financave, kështu që neni që referoi zoti Beqaj, është në zbatim të plotë të ligjit organik të buxhetit.

Së dyti, në raport me çështjet, të cilat lidhen me buxhetin, më lejoni të shpreh se elemente të caktuara të tij kanë të bëjnë me shpenzimet zë më zë, siç janë shpenzimet e infrastrukturës rrugore apo shpenzimet që kanë ministritë e tjera. Besoj se ministrat respektivë do të jenë këtu në këtë komision dhe do t'i respektojnë pyetjet një për një, por mund t'i jap përgjigje pyetjes së fundit. Nuk është ky lot. Arsye pse nuk është ky lot mund do ta merrni në vijim, por në parim ne kemi treguar një element të kujdesshëm në zërin e buxhetimeve për të përfunduar rrugë, të cilat janë shumë më të avancuara, progresi i të cilave në 2-3 vjetët e fundit ka qenë i dukshëm, në mënyrë që këto rrugë të përfundojnë përpara se ne të angazhohemi për rrugë të tjera, qoftë edhe sikur të jenë pjesë të loteve, të cilat mund të jenë nisur më parë.

Së dyti, siç e thamë, edhe në rastin rrugës Qafë Plloçë ka rrugë, të cilat nuk janë të gjitha me financim të brendshëm, janë me financim të huaj. Më lejoni të them se në vitin 2019 të gjitha rrugët me financim të huaj; kanë pasur një ritëm shumë më të ngadaltë se projektet me financim të huaj kanë pasur një performancë shumë më të dobët se sa ato me financim të brendshëm. Konkretisht, të gjitha investimet publike deri më tani janë në nivelin e 65%-shit, krahasuar me ato me financim të huaj që janë nën 50%. Unë jam shumë dakord me zotin Beqaj që në relacionin e tij kërkon që ne të jemi të kujdesshëm në disa elemente shumë të rëndësishme, sidomos në infrastrukturën rrugore, që kanë të bëjnë me shpronësimet. Më lejoni të them se qeveria ka marrë një nismë, e cila shumë shpejt do të jetë pjesë e një vendimi të Këshillit të Ministrave për krijimin agjencisë së shpronësimeve për interes publik për të adresuar dy elementet e saj të rëndësishme.

Së treti, adresimin e projeksioneve më korrekte për të përfshirë edhe fondin e shpronësimeve në vijim, sikurse edhe pagesën e detyrimeve të prapambetura, të cilat do të paguhën sipas kësaj agjencie në një plan pagese për një periudhë të caktuar kohe, përfshirë edhe normën e interesit për vitet e këtij plani pagese. Besoj se shumë shpejt, këtë të mërkurë ose të mërkurën tjetër, do të jetë në tryezën e Këshillit të Ministrave, kështu që problemi i shpronësimeve që u adresua më parë nga zoti Beqaj, mund të gjejë një zgjidhje konkrete në këtë ligj.

Në raport me çështjen e sistemit të miradministrimit, unë nuk do të shkoj në detaje se cila do të jetë politika e qeverisë shqiptare në raport me amnistitë fiskale në parim.

Miradministrim nuk nënkupton gjithmonë falje, miradministrimi do të thotë analizim i strukturave dhe i të gjitha politikave, dhe këtë gjë jemi duke bërë.

Së pari, nëpërmjet projektit që unë e përmenda pak më parë dhe me ndihmë të FMN-së ne përfundojmë brenda këtij viti analizën e të gjitha proceseve, të cilat vitet e fundit kanë ndikuar jo pak në incentivin, por edhe në lehtësinë e të bërit biznes, të cilat do t'i analizojmë me *costbenefit* së bashku me ekipet tona të brendshme dhe do t'i ndajmë edhe me komisionet parlamentare. Kjo do të jetë si një bazë për të projektuar politikat fiskale afatmesme.

Së dyti, gjithsesi, informaliteti është një proces në adresim. Unë e përmenda pak më parë, por zoti Gjuzi, meqenëse erdhi me vonesë, nuk mori përgjigje. Besoj se, po t'u referohet minutave të takimit, do ta adresojë në këtë kontekst që të mos biem në përsëritje.

Sa i takon luksit, e ftoj të vijë ta shikojë Ministrinë e Financave, por, mbi të gjitha, t'i marrë të gjitha shpenzimet e Ministrisë së Financave zë më zë dhe ta adresojë këtë në raport me atë produkt që prodhon Ministria e Financave në të tria dimensionet e saj: financë, ekonomi dhe punësim por, mbi të gjitha, me të gjithë kapituajt që po negocion për integrimin europian.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Po, zoti Gjuzi, shkurt, ju lutem.

Kujtim Gjuzi – Në radhë të parë, unë dua ta falënderoj ministren, është një zonjë e nderuar dhe besoj se deri në këtë moment nuk kam pasur asnjë kundërshti ndaj jush. Ju besoj se e dini që unë bëhem agresiv, kur shikoj një gjë që nuk shkon.

Niko Peleshi - Shumë pak e kanë këtë privilegj.

(Diskutime pa mikrofon)

Kujtim Gjuzi – Atëherë, duhet të thoshit: “I nderuar zoti Gjuzi”. Megjithatë, ju jeni një zonjë dhe i keni të gjitha hapësirat, por unë kam qenë në ministrinë tuaj dhe, kur them që kanë shpenzime të tepërta, të mos bëjmë, ndonjë gjë, publike këtu, se jemi edhe kolegë dhe nuk na intereson.

Faleminderit, zoti Kryetar!

Faleminderit, zonja Ministre!

Niko Peleshi – Nëse nuk ka pyetje të tjera, dua të bëj unë një pyetje, më shumë e kam kuriozitet dhe nuk është lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me buxhetin. Duke pasur një vlerësim të mëparshëm për zonjën Ministre dhe për mënyrën se si zoti Beqaj e tha me prurëncë, por, prurëncia sot, është gjëja më e çmuar për ekonomitë tona se si po drejton institucionin e

Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë gjë që reflektohet edhe në përmbajtjen e këtij buxheti. Unë jam kurioz të di nëse gjatë kësaj periudhe keni rritur të ndërtoni një metodologji për të siguruar furnizimin me burime të politikave krosektoriale, gjë që është handicap jo vetëm i buxhetit tonë në vite, por me aq sa unë e njoh edhe të buxheteve të të gjitha qeverive, edhe ato të vendeve të zhvilluara. Problemi i keqkonceptimit të buxheteve të qeverive, që e pranojnë edhe vetë, është se buxhetet hartohen sipas një *wishlist* të çdo ministrie dhe më pas në varësi të fondit që qeveria ka e sharton këtë *wishlist*. Çështja është se shumë politika zhvillimore janë krosektoriale. Për shembull, marrim turizmin, që të zhvillojmë turizmin nuk mund të financojmë thjesht programet e Ministrisë së Turizmit, por duhet që çdo projekt i turizmit apo program turizmi të financohet si një politikë krosektoriale e disa sektorëve. Pra, duhet të financohet rruga për të zhvilluar një zonë me potencial turistik: energjia elektrike; bujqësia e zonës; agroturizmi e të tjera.

Në mënyrë që këto të gjitha të plasim me njëra-tjetrën, politika e hartimit të buxhetit duhet të jetë jokonvencionale, por unë nuk e kam gjetur në asnjë buxhet, për hir të së vërtetës, edhe me kontaktet që kemi pasur me kolegë të huaj, një metodologji, e cila siguron financimin në mënyrë horizontale të buxhetit, jo vertikale, pra financimin e politikës, jo financimin e sektorit, sepse pastaj është e vështirë që t'i paketojmë financimet e sektorit për të furnizuar politikën që është *cross-sektoriale*. Dua thjesht të di: a ka një avancim këtë vit ose, nëse po planifikohet një lloj metodologjie që e tejkalon këtë handicap apo që e përballon këtë sfidë, që e kanë të gjitha buxhetet?

E dyta, zoti Beqaj, me të drejtë, tentoi t'i vinte një emër buxhetit, dhe mua më duket korrekte, siç ai e quajti, do të doja të dija: si e quani ju këtë buxhet, çfarë emri i vendosni këtij buxheti?

Faleminderit!

Anila Denaj – Zoti kryetar, në kontekst me emrin, çdo komision (ky është i treti tek i cili marr pjesë) i ka gjetur një emër. Mendoj se është e dukshme se nga ana e Ministrisë së Financave ne e quajmë një projektbuxhet (unë e thashë edhe në Komisionin e Ekonomisë), i cili synon konsolidimin fiskal, miradministrimin e të ardhurave dhe rritjen e punësimit. Këta do të ishin tre pilarët kryesorë të ardhur nga ne. Sigurisht, në Komisionin e Ligjeve u quajt projektbuxheti i reformës në drejtësi, për arsye të investimit që është bërë në këtë fushë, ndërkohë te komisioni

juaj kemi kontekste të ndryshme. Unë nuk e dija që ishte kaq i rëndësishëm emri, megjithatë do ta konsolidojmë këtë gjatë këtij procesi.

Për të thënë atë që është e vërteta, e cila është komentuar edhe pak më parë, fokusi i ministrisë është ruajtja e parametrave makroekonomikë fiskalë, si një parakusht shumë i rëndësishëm për ta rritur rritjen ekonomike dhe për të ulur borxhin, qoftë për të synuar edhe angazhimin që kemi marrë si ministri prej vitesh.

Në lidhje me përmirësimin e metodologjive, unë jam shumë dakord me ju, ka shumë elemente që mund të përmirësohen në metodologjinë e përgatitjes së buxhetit. Më lejoni të theksoj se në aspektin e ndarjes *cross-sektoriale* nuk ka një metodologji të mirëfilltë, nuk ka asnjë projekt për ta bërë këtë vitin që vjen, sepse duhej ta kishim nisur punën që sot për ta bërë gati, por kjo nuk do të thotë që mund të mos jetë. Megjithatë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka menaxhuar prej vitesh dhe po menaxhon një reformë të financave publike, e cila konsiston edhe në një *upgrade*-im të sistemeve, të cilët do të bëjnë të mundur edhe marrjen e informacionit në kohë reale. Sepse që të bësh politika, duhet të kesh një analizë të mirë me të dhëna dhe jo vetëm me *Excel*-e. Ne sot po shkëputemi nga *Excel*-et, që i marrim edhe të printuara, tek ato që pretendojmë me reformën e financave publike, një projekt i mbështetur nga Komuniteti Europian që të kemi, le të themi, projeksione buxheti në bazë të projekteve të dobishme dhe efektive. Do të ketë *key performance indicators* në dy-tre vjetët e ardhshëm se cilat do të jenë projektet që do të marrin më tepër financim ose që do t'u shkëputet financimi. Sigurisht, ne mund ta mendojmë këtë të ndërlidhur edhe me elemente *cross-sektoriale*, të cilët nuk mungojnë, edhe pse nuk janë të kuantifikuar. Pse?

E para, sepse ne sot, si rregull, i diskutojmë prioritetet sipas strategjive dhe projektbuxheti diskutohet përpara se të shkohet në mbledhje qeverie në një komitet, i cili përfshin të gjithë ministrat, ku në fund të ditës secili jep opinionin e tij nëse secili prej projeksioneve mund të mbështesë ose të frenojë relativisht.

Ajo që thatë ju, kishte të bënte me kuantifikimet dhe me matjet e tyre. Sigurisht, në të ardhmen ne mund ta marrim këtë për ta zhvilluar më tej.

Nuk e di nëse do të ishte e nevojshme të futemi në detaje, për të cilat ne si Ministri e Financave dhe Ekonomisë jemi të hapur t'u kthejmë përgjigje me shkrim, pasi mendoj që ndoshta për shumë nga pyetjet nuk janë marrë të gjitha përgjigjet, të cilat mund të jenë specifike.

Por shifrat, me të marrë pyetjet sot, do t'i kemi gati nesër, flas për pyetjet që kanë ngelur pa përgjigje.

Niko Peleshi – Shumë faleminderit!

Nëse më lejoni, fjalën po ia jap zotit Beqaj, që është relatori, i cili ka diçka për të shtuar.

Ilir Beqaj – Qoftë në prezantimin tuaj, qoftë në logjikën e konsolidimit për vitin e ardhshëm, por edhe praktikisht tek të dyja ligjet që shoqërojnë paketën, fakti se legjislacioni, si e keni quajtur këtu, ligji “Për faturën dhe sistemin e monitorimit” nuk ka ardhur ende, jemi disi *binded* këtu, se ligji nuk ka hyrë ende në diskutim. Unë druham që si do ta zgjidhim këtë ngërç më 1 janar, për sa kohë nuk e kemi as në kalendar, aq më shumë që unë besoj se, madje kjo do të ishte një pyetje: sa e përgatitur është administrata tatimore që të fillojë zbatimin e këtij ligji më 1 janar të vitit 2020? Edhe pse nuk e kemi këtë ligj në rend dite, por fakti që citohet në relacion, e kanë përmendur në dy projekte, është disi...

Anila Denaj – E para, më duket çudi që nuk ka ardhur ende. Do të interesohem për këtë, pasi është aprovuar që të mërkurën e kaluar në mbledhje qeverie dhe me procedurë të përshpejtuar është kërkuar që të kalojë për diskutim në komisione.

E dyta...

(Deputeti Beqaj flet pa mikrofon.)

Në Komisionin e Ekonomisë e kemi dhe prandaj duhet t'i shikojmë.

(Deputeti Beqaj flet pa mikrofon.)

Robert Bitri – Po të jetë në ndonjë komision, në kalendar duhet të jetë futur.

Ilir Beqaj – Por nuk është miratuar në seancë plenare kalendar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anila Denaj – Dua të jap përgjigje për pjesën që më takon mua, edhe pse këtë pjesë, sigurisht, duhet ta adresojmë, pasi na shqetëson. Ne do të kërkonim që kjo të adresohet edhe nga strukturat e tjera, pasi projektligji për faturimin ose, i quajtur ndryshe, për fiskalizimin, është hedhur për konsultim publik në datën 31 korrik të këtij viti. Ka pasur një periudhë relativisht të gjatë kohe, rreth 1 muaj e gjysmë, konsultimi publik me të gjitha grupet e interesit. Mund të them se konsultimi i bërë në të gjitha tryezat, të paktën dhjetë të tilla, ka sjellë një përmirësim të dukshëm edhe të projektligjit që ne çuam për miratim në Këshillin e Ministrave, pasi nga grupet e interesit u kërkuar të sqaroheshin disa nene apo të ndryshonin. Mund të them me plot bindje se është një nga ligjet që është konsultuar më shumë për të sjellë të paktën sqarim mes palëve.

Duke qenë se është një ligj i cili krijon një impakt tek të gjithë tatimpaguesit dhe jo gjithmonë është i mirëpritur një ndryshim, pasi e kuptojmë që disa vite nuk pritet që ndryshimet, qoftë edhe në teknologji, të jenë të lehta për t'i xhestuar, ne kemi parë që afati kohor, i cili starton më 1 janar të vitit 2020, por ka një periudhë transitore gjashtëmujore, është afati më optimal për të implementuar këtë proces.

Në fillim e tij, në datën 1 janar, ju do ta shikoni edhe te dispozitat kalimtare, janë dy afate. Për të gjithë tatimpaguesit, të cilët hyjnë rishtazi në treg, ka një afat të caktuar tremujor se si do të adresojnë marrjen e instrumenteve për të dhënë informacion, sikurse edhe të gjithë tatimpaguesit aktualë, të cilët duhet të bëjnë *upgrade*-imin e sistemit.

Dua ta theksoj edhe një herë se ky sistem nuk i eliminon kasat fiskale, në qoftë se ky është një problem i lakuar edhe në tryeza të caktuara; ai e rrit nivelin e të dhënave si rezultat i një aplikacioni, pra i implementimit të një *software*-i mbi të njëjtat struktura *hardware*, qoftë kasa fiskale, dhe kryesisht ndihmon që përtej kasave fiskale, ata që janë sot duke dhënë zgjidhje të *software*-it, të mund të japin zgjidhje, edhe të *hardware*-it, i cili mund të jetë edhe ky apo ekrani, le të themi, kompjuteri që ka secili biznes.

Ne implementojmë vetëm një kërkesë protokolli për një *software*, i cili, në dijeninë tonë, deri tani nga kompani, të cilat janë duke testuar dhe më vonë do të certifikohen sipas një rregulli të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave brenda këtij muaji. Gjykohet që çmimi i tij të jetë diku te 30 euro, pra nuk është një kosto e mirëfilltë. Sigurisht, që të aplikosh këtë *upgrade*-im sistemi mbi të njëjtat pajisje, qoftë kasa fiskale, do të thotë që këto të fundit të jenë të tilla që ta mbajnë këtë *software* në memorjen e tyre. Për këtë, kompanitë e kasave fiskale kanë kërkuar gjashtë muaj kohë; në fillim kërkuan dy muaj, dhe ne, në dobi të një procesi, thamë: po, do të marrim kohën e mjaftueshme që të kemi mundësi që, si prodhuesit e kasave ose tregtuesit e kasave fiskale, ashtu edhe ofertues të tjerë të zgjidhjeve, sepse mund të mos jenë vetëm ata, të kenë mundësi të operojnë në një treg për një periudhë gjashtëmujore, si dhe me kostot që do të ofrojnë. Meqenëse mundësia është më e gjerë sesa vetëm produkt (kasë fiskale), do të ketë më shumë mundësi, pra tregu të ketë mundësi të ulë edhe çmimet.

Në fakt, është shumë e rëndësishme, në raport me komunikimin me publikun, që jo vetëm ne, por të gjithë aktorët të angazhohen më shumë, kjo nuk është mohuar, nevoja që ligji të hyjë në zbatim dhe menjëherë pas kësaj ne t'u bëjmë të qartë të gjithë përdoruesve të këtyre aplikacioneve zgjidhjet që kompanitë do të japin.

Niko Peleshi – Shumë faleminderit!

Po, zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Dua të merrem sërish me pjesën që e shikoj pak me siklet në zbatim. E di se përfitimet do të jenë shumë të mëdha, por, në gjykimin tim, do të jenë përfitime shumë të mëdha, në radhë të parë, për bizneset, sepse, në gjykimin tim, kasa fiskale i vlen fillimisht biznesit, jo qeverisë.

Kush është i një brezi që ka qenë 15 vjeç para '90-ës, ka pasur edhe atëherë kasa fiskale kur nuk ishte as taksa kur edhe shteti ishte vetë Ali, vetë Kadi. Sepse, në radhë të parë, është inventar dhe magazinë që i vlen vetë atij që ka, pra edhe biznesit të vogël, edhe biznesit të madh. Madje, në këtë mënyrë, biznesit të vogël (atij që punon vetëm me një regjistër) shteti i mban edhe *software*-in e kontabilitetit të vet; duhet ta shohë kështu. Por unë druham tek ofrimi i shërbimit të internetit, sepse sot nuk do të shkarkojë më vetëm në fund të ditës, por do ta ketë, madje duhet të marrë një konfirmim që ta kryejë.

Me thënë të drejtën, nuk e di pse, por sidomos tregu ose shërbimi i operatorëve të mëdhenj të telefonisë celulare vitet e fundit ka ardhur në përkeqësim. Këta që ofrojnë 4G dhe 5G...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, 3G dhe 4G, praktikisht shërbimin e kanë jashtëzakonisht të dobët. Këtë e shoh si një nga pikat kritike, që, sigurisht, në pamje të parë as qeveria, as ministria nuk ka çfarë bën, sepse ne e kemi zgjidhur me operatorë privatë shërbimin e internetit, por një shërbim me fibër ose me kabull ka një kosto, sigurisht, jo të vogël. Nuk duam të krijojmë përsëri rrjeta kabllore nëpër qytetet tona vetëm për këtë arsye, por këtë e shoh si një nga pikat delikate që do të krijojnë probleme. Nuk do të doja që nga mosofrimi i një shërbimi cilësor komunikimi apo interneti, administrata të fillojë të prodhojë gjoka, penalizime e të tjera.

Zoti kryetar, mendoj se kjo mund të jetë një nga pikat që mund të rrezikojë një fillim të suksesit të kësaj gjëje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Cili vend e ka bërë, të gjithë ia kanë parë hajrin për dy-tre vjet: edhe Sllovakia, edhe Kroacia apo edhe vende të tjera, por fakti që ka nja dy vjet që këto kompani celulare praktikisht në Shqipëri kanë mbetur në vendnumëro në kuptimin e cilësisë e të tjera, e shoh si një gjë pak me siklet.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Po, zonja Ministre.

Anila Denaj – 92% e territorit mbulohet me internet, ndërsa 8% janë pikat e bardha dhe, sigurisht, këto të fundit janë në zona malore, ku edhe numri i bizneseve do të jetë aq i vogël, sa që përdorimi i mjeteve alternative për të raportuar në administratën tatimore sot është i mundur.

Te 92%-shi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, dakord, ka mjete alternative.

(Deputeti Beqaj flet pa mikrofon.)

Sigurisht, duhet të ishte prezent përfaqësuesi i AKEP-it për të dhënë përgjigje për këtë aspekt, por numri i bizneseve (për atë që më takon mua si përgjegjësi fushe) ose i transaksioneve që ndodhin në Valbonë nuk është dhe nuk duhet të jetë ngërç për ligjin e fiskalizimit; kjo është e sigurt.

Së dyti, pjesa më e rëndësishme e shërbimit nuk është në varësi nga shërbimi i internetit.

Më lejoni të theksoj që sot të gjitha konsultimet publike të bëra me të gjithë aktorët e biznesit konsolidojnë që ky problem nuk është kyç. Problemi më i rëndësishëm është efekti kohë, të cilin e dhamë. Edhe në kontekstin e afatit dhe të startimit të tij, për sa kohë tani u vërtetua që është edhe në axhendë, besoj se kolegët do ta informojnë komisionin. Unë mendoj që ne të nisim një projektligj, i cili, siç e thamë edhe pak më parë, në të gjitha vendet ku është implementuar, ka sjellë rezultat: në Kroaci, 40%; në Çeki, 35%. Ndërkohë, ne, sigurisht, nuk projektojmë 35%-40%, por 15% deri në 20%. Të jemi prudentë, sepse janë tri faza të saj: marrëdhënia biznes me klient, që do të marrë kohën që ne kemi treguar vullnet për ta dhënë, në mënyrë që të gjitha palët të jenë të harmonizuara për një produkt, qoftë edhe për arsye interneti, faturimi ose informacioni; marrëdhënia biznes me biznes, ku shqetësimi i zotit Gjuzi në marrëdhënie me bankat është shumë i saktë, por në marrëdhënien biznes me biznes, e cila do të konsolidojë dhe do të certifikojë faktin se sa nga transaksionet në Shqipëri janë të kryera kesh dhe sa do të kryhen nëpërmjet sistemit bankar, atëherë është shumë e rëndësishme që i gjithë ky proces të konsolidohet në harkun kohor të dy vjetëve, në qoftë se duam të luftojmë seriozisht informalitetin.

Në qoftë se duam të luftojmë me aksione, me vizita ose me kryqëzim informacionesh, nuk do të arrijmë dot as 15%, as 20%. Sigurisht, ka një fillim dhe fillimi mund të jetë më i

ngadaltë, mund të ketë probleme informatike, mund të ketë probleme interneti, por më thoni një proces që nuk ka pasur problematika. Rëndësi ka qasja. Ne nuk mund të shtyjmë një projektligj, i cili përmirëson vetëm informacionin e të dhënave dhe që absolutisht duhet të shoqërohet me një administratë moderne tatimore, jo me të njëjtën administratë që është sot, me struktura më mirë të koordinuara mes tatimeve, doganave dhe inspektorateve të tjera, në mënyrë që biznesit t'i shkohet për atë problematikë që evidentohet dhe jo çdo ditë për problematika të ndryshme. Ky është objektivi ynë, ky është qëllimi, por për këtë duhen të dhëna, që sigurisht nuk merren brenda një dite.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Shumë faleminderit, zonja Ministre!

Kjo është me të vërtetë e saktë, nisur edhe nga eksperiencia që kemi parë ndër vite, ku, sa herë ka pasur një zgjidhje inovative, ka pasur skepticizëm dhe rezistencë, por kur nuk ka zgjidhje tjetër, biznesi apo nevoja e gjen rrugën. Edhe në këtë rast, në qoftë se ka zona të pambuluara nga interneti, mund të inkurajohen apo qoftë edhe të mbështeten financiarisht aty ku nuk ka fizibilitet, *provider* privat për të siguruar internetin, për shembull, në Luginën e Valbonës për 100 ose 200 bizneset aty.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë ju falënderoj shumë edhe për prezantimin e buxhetit, edhe për inovacionin në qasjen tuaj për rritjen e të ardhurave, duke kaluar nga një qasje me aksione, në një qasje të strukturuar dhe inovative! Shumë faleminderit për kohën, edhe në emër të kolegëve të komisionit!

MBYLLET MBLEDHJA